



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 82 Akti

Nr. 109 Vendimi
Tiranë, më 19.02.2019

VENDIM

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Suela Zhegu	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në Tiranë, në datën 12 shkurt 2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irma Balli**, Prokurore/Drejtuese e Prokurorisë së Apelit Korçë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit znj. Irma Balli në seancë publike, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, dëgjoi vëzhguesin ndërkombëtar, dhe si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë e Apelit Korçë, duke qenë njëkohësisht dhe drejtuese e kësaj prokurorie dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Alma Faskaj dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2017, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj”, nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, për arsye shëndetësore, u zëvendësua me anëtarën Suela Zhegu.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK); dhe iii) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

Me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Në respektim të legjislacionit

në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.

Trupi gjykues, më datë 23.01.2019, vendosi: i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Irma Balli, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për kalimin e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 – 47 dhe 35 – 40 të Kodit të Procedurave Administrative; iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

Trupi gjykues, më datë 23.01.2019, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: i) rezultatet e hetimit kryesisht; ii) kalimin e barrës së provës bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe mbi të drejtën për të dhënë shpjegime dhe për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda datës 01.02.2019, nga marrja e njoftimit me *e-mail*; iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 – 47 dhe 35 – 40 të Kodit të Procedurave Administrative; iv) përbërjen e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

Me vendimin nr. 3, datë 05.02.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Irma Balli, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 12.02.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë. Më datë 12.02.2019, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore me prezencën e subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, më datë 26.01.2019, nëpërmjet komunikimit me postë elektronike, i bën me dije Komisionit se është njohur me rezultatet paraprake të hetimit vetëm për kriterin e pasurisë dhe se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për sa më sipër i ka kërkuar Komisionit të njihet me rezultatet paraprake të hetimit për dy kriteret e tjera, kontrolli i figurës dhe i aftësisë profesionale.

Trupi gjykues, më datë 29.01.2019, ka informuar subjektin e rivlerësimit se ka përfunduar procesin e hetimit kryesisht dhe ka dërguar barrën e provës vetëm për kriterin e pasurisë duke rezervuar të drejtën që të shprehet për më shumë në vendimin përfundimtar. Në lidhje me këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se dispozita që legjitimon dhe normon këtë procedurë dhe vendimmarrje, është pikërisht pika 2, e nenit 4, e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin*

përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.” Në bazë të këtij parashikimi ligjor, Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tre kriteret e vlerësimit. Gjatë këtij hetimi, Komisioni pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhej edhe vetëm për këtë kriter, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kritereve të tjera. Ky qëndrim është unifikuar edhe në vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si p.sh., në vendimin nr. *** regjistër (RJ), datë 03.09.2018, nr. ** vendimi, datë 23.10.2018.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, më datë 04.02.2019, paraqiti kërkesë për marrjen dhe shqyrtimin e provave në procesin e rivlerësimit, si: për këqyrjen fizike të librezës origjinale të kursimit të z. P. R.; thirrjen për t'u pyetur të ekspertit të licencuar, z. J. S., thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. B. Z. dhe z. M. K., për të marrë dëshmitë e tyre, për të provuar prapësimet e saj dhe kundërshtuar rezultatet e hetimit paraprak.

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve bazuar në nenin 49, të ligjit nr. 84/2016, analizoi çështjen në tërësi, duke arsyetuar se:

1. Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për këqyrje fizike të librezës origjinale të kursimit të z. P. R., ky veprim konsiderohet i panevojshëm, referuar germës “a”, të pikës 6, dhe pikës 7, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi trupi gjykues nuk ka dyshime në lidhje me origjinalitetin e saj.

2. Në lidhje me kërkesën e subjektit për pyetjen e shtetasit J. S., ekspert licencuar në fushën e vlerësimeve të objekteve, Komisioni ka konstatuar se marrja e kësaj prove është e panevojshme referuar pikës 6, të germës “a”, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi raporti i vlerësimit i hartuar nga z. J. S. është pjesë e dokumentacionit të depozituar nga ana e subjektit në ILDKPKI, si pjesë e dokumentacionit që shoqëron procesverbalin e mbajtur më datë 30.06.2016, midis subjektit dhe inspektorit të këtij institucioni. Ky dokumentacion është vënë në dispozicion të Komisionit nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 07.12.2018, gjithashtu nga ana e subjektit janë dhënë sqarimet përkatëse në shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit duke u pasqyruar edhe baza ligjore ku është bazuar akti i vlerësimit.

3. Në lidhje me kërkesën e subjektit për thirrjen të z. B. Z. dhe z. M. K., në cilësinë e dëshmitarit, për të dhënë sqarime të situatës faktike në lidhje me subjektin e rivlerësimit, Komisioni çmon si të panevojshme këtë dëshmi, pasi referuar germës “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, marrja e kësaj prove është e panevojshme për shkak se të dy personat e kanë shprehur qëndrimin e tyre në deklaratën noteriale të datës 29.01.2019 (dërguar me postë elektronike pranë Komisionit), dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e kërkesës së subjektit në lidhje me kërkesat e sipërtrajtuara.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 06.02.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, më datë 12.02.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ajo parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Irma Balli ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë gjithë fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, e cila është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr.

9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, më datë 26.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- b) Deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- ç) Provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, si: nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime”, zyra noteriale, etj;
- d) Deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti në rrugë zyrtare me postë dhe me anë të komunikimit elektronik;
- dh) Shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe iv) evidentimin e ekzistencës së

mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë – shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, më datë 26.01.2017, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë – shtojca 2, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➔ **Në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, subjekti deklaroi këto pasuri:**

- 1. Bashkëpronare në ¼ e një sipërfaqe trualli prej 170 m² e trashëguar dhe të një ndërtese me sipërfaqe 120 m², në katin e parë të së cilës zhvillohet aktivitet për shitje me pakicë karburanti, vajra etj., ndodhur në shëtitoren “****”, Korçë.
Trualli, pronë e trashëguar në favor të shtetasve N. R, P. R dhe M. K. (S). ¼ e truallit - dhuruar subjektit prej bashkëpronarëve.
Ndërtimi i objektit bazohet në lejen e ndërtimit dhënë, në datë 10.11.1997, nga KRRT-ja Korçë, në emër të z. N. R.
Pjesa takuese: 25 %.**

Burimi i krijimit i deklaruar:

- Vlera prej 3.500.000 lekë, plus aksesorë si pompa, tendë, reklamë etj., janë dhënë nga firma “****”;
- Të katër bashkëpronarët kanë kontribuar së bashku ku pjesa më e madhe ka qenë nga babai, i cili më pas ka investuar pjesën më të madhe të realizuar nga të ardhurat sidomos nga qiraja;
- Në investimin fillestar, subjekti ka kontribuar me vlerën prej 1.000.000 lekë, të cilat janë kryesisht pjesë e kursimeve dhe nga puna e z. A. B, bashkëshorti i subjektit, në Greqi;
- Investimi nga N. R, babai i subjektit dhe P. R, vëllai i subjektit, ka qenë në vlerën rreth 3.500.000 lekë. Z. N. R ka pasur të ardhura nga babai i tij, që ka qenë emigrant në SHBA ku edhe ka vdekur, ndërsa z. P. R. ka pasur kursime nga puna si emigrant në Greqi;
- Znj. M. S, trashëgimtare e vetme e familjes birësuese *** ka kontribuar me vlerën prej 1.000.000 lekë;
- Më pas, objekti ka vazhduar me pjesë të fitimit, apo dhe pjesë të qirasë, ku pjesën më të madhe e ka vënë babai, i cili më pas ka disponuar pjesën e tij në favor të nipërve nga djali, nga e cila është në funksion vetëm kati i parë.

❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

1.1 Mbi dokumentacionin tekniko-ligjor për pasurinë e paluajtshme “Karburant dhe dyqan”, të ndodhur në Drejtorinë e Arkivave Shtetërore Vendore Elbasan, si dhe atë të përdorur nga subjekti për regjistrimin e kësaj pasurie në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë.

Komisioni ka kryer hetim të thelluar në lidhje me këtë pasuri nga ku rezulton se:

Nga korrespondenca me ZVRPP-në Korçë^{2/3} rezulton se regjistrimi i pasurisë truall me sipërfaqe 170 m², karburant dhe *** + ***, me sipërfaqe totale 120 m², është bërë në bazë të vendimit nr. ***, datë 29.10.1993, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Korçë, në bazë të të cilit trashëgimtarëve N. R, U. Sh, J. Sh. u njihet dhe u kthehet trualli i lirë me sip. 170 m² të ish-pronarit V. Sh, si dhe lejes së ndërtimit nr. *** prot., ku me vendimet nr. ***, datë 10.11.1997, dhe nr. ***, datë 20.06.1997, të KRRT-së Korçë, i është dhënë leja e ndërtimit për objektin “Pikë karburanti”, ndodhur në Rr. “****”, sipas projektit të miratuar.

Sipas praktikës së dërguar nga ZVRPP-ja Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2018, regjistrimi fillestar i karburantit është bërë në bazë të dokumentacionit të depozituar nga ana e subjektit në ZVRPP-në Korçë, nëpërmjet aplikimit nr. ***, datë 18.07.2000, dokumentacion i ndodhur në referencën nr. ***. Në këtë referencë, veç të tjerash, si dokumentacion justifikues për regjistrimin e karburantit, janë depozituar nga subjekti edhe:

- a) Planimetria e katit përdhes;
- b) Planimetria e kati I;
- c) Planimetria e katit II;
- d) Planimetria e katit III;
- e) studim urbanistik për objektin “pikë karburanti”, ndodhur në Rr. “F. N.”, pronari – N. R (në objektin e pasqyruar në hartën e studimit urbanistik, nuk konstatohet që të jetë shënuar numri i kateve 3 ose 4, por 1 ose 2, nuk është e qartë).

Nga korrespondenca e kryer midis Drejtorisë Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me shkresat nr. *** prot., datë 27.12.2018, dhe nr. ***prot., datë 14.01.2019, janë dërguar në Komision dokumentet për dhënie leje ndërtimi për objektin “Pikë karburanti” në emër të z. N. R; fotokopje dokumenti të nxjerrë nga ASHV-ja Korçë; ***. KRRT Korçë, viti 1997; ***. Dosja e vendimeve të KRRT-së Korçë; ***. 311.

Në dokumentin “Kërkesë për shesh ndërtimi”, të ndodhur në dosjen arkivore në Drejtorinë Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan, në pikën 8 të tij specifikohet se sheshi është kërkuar për ndërtimin e objektit “Pikë karburanti” me numër katesh 1 dhe 2, nga shtetasi N. R, pra, numri maksimal i kateve i përcaktuar në kërkesën për shesh ndërtimi, është 2.

² Shihni në dosjen e Komisionit shkresën nr. *** prot., datë 04.12.2018.

³ Shihni në dosjen e Komisionit shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, është konstatuar se pjesë e praktikës së kësaj leje ndërtimi, të ndodhur në dosjen përkatëse në Drejtorinë Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan, nuk janë planimetritë e kateve I, II dhe III, dokumente që janë depozituar nga subjekti në ZVRPP-në Korçë për regjistrimin e karburantit dhe të një godine 3 kate + papafingo.

Në dosjen e Arkivit ndodhet një planimetri e katit TIP e cila nuk rezulton e depozituar nga subjekti në ZVRPP-në Korçë.

Nga një krahasim i thjeshtë, vërehet se planimetritë e kateve I, II dhe III të depozituar nga subjekti në ZVRPP-në Korçë, por që nuk ndodhen në dosjen arkivore të lejes së ndërtimit, janë produkt i planimetrisë së katit TIP, të fotokopjuar, dhe pikërisht tek fjala "TIP", për çdo rast fotokopjimi duket se është ndryshuar nga "TIP" në "I-rë", "II-të" dhe "III-të". Çdo e dhënë tjetër në të tria planimetritë duket se është e njëjtë me të dhënat e pasqyruara në planimetrinë e katit TIP.

Subjekti, në shpjegimet e tij, deklaron se:

“Gjithë praktika e dhënies së lejes së ndërtimit deri në kolaudim, është në emër të babait të saj, z. N. R., i cili ka qenë investitori kryesor dhe se në këtë historik unë nuk kam pasur lidhje me pronën truall në momentin e marrjes së lejes, të përpilimit të dokumentacionit, planimetrive të objektit etj. Gjithë praktika e lejes është marrë nga babai im.

Momenti i regjistrimit të pronës lidhet me detyrimet e specialistëve të zyrës për të bërë kontrollin dhe saktësinë e dokumentacionit në përputhje me ligjin dhe në asnjë moment nuk më ka shkuar ndërmend të bëj verifikimin e dokumenteve që kërkohen nga ZVRPP-ja apo të bëj ballafaqimin me zyra të tjera ku gjenden këto dokumente sepse nuk kam pasur arsye.

Për konstatimin e bërë nga ana juaj vihem në dijeni nga ky rezultat hetimi dhe nuk kam çfarë të them për rastin.

Nga komunikimi dhe sqarimi me ekspertë të fushës më thonë kati tip është kat i njëjtë për të gjithë katet e një objekti me më shume se një kat ashtu siç është dhe siç duket nga pamja ballore. Po kështu leja e ndërtimit i takon vitit 1997, kur ka pasur mjaft probleme si me institucionet ku jepej leja ashtu edhe me zbatimin projekteve për shkak të problematikes, mangësive në ligjin “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” veçanërisht me saktësimin e dokumenteve.”

Gjithashtu, subjekti, në shpjegimet e dhëna prej tij në seancë dëgjimore sqaron se:

“Kur familja më bëri pjesë të pronës dhe të biznesit familjar, jam mjaftuar të shikoj certifikatën e pronësie dhe hipotekimin e objektit, pa menduar se duhej të kontrolloja e verifikoja skicat e planimetritë e depozituara më parë në institucionet kompetente.

Nga praktika që kam në dispozicion, konstatoj se ZVRPP-ja Korçë, ka kërkuar disa herë të pajiset me dokumentacionin e munguar për këtë dosje dhe përfundimisht ka lëshuar certifikatën e pronësisë.

Regjistrimi i pronës bëhej bazuar në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme i cili referon në nenin 12/1 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”. Është zyra e cila ka dhënë lejen e ndërtimit dhe që komunikon me ZVRPP-në që dërgon praktikën pranë ZVRPP-së ku bëhet verifikimi i dokumentacionit dhe regjistrimi i pronës.

Nuk mund të mbaj asnjë përgjegjësi dhe aq më pak të jap shpjegime lidhur me gjendjen e skicave e planimetrive të ruajtura dhe sistemuara në zyrat e ZVRPP-së Korçë, pasi ky është detyrim ligjor dhe i vetëm këtij institucioni. Nuk rezulton që unë të kem depozituar dokumentacionin në zyrën e ZVRPP-së. Nuk rezulton ndonjë aspekt dokumentar a procesverbal për nominimin e dokumentacionit të dorëzuar.

Se si është gjendja e dokumenteve në këtë institucion mund të gjykohet nga fakti se inventari i dosjes është bërë, më 25.08.2008, pra 8 vjet më vonë se administrimi real i dokumenteve. Në këto kushte na lind e drejta të themi se janë administruar dokumentet e kërkuara nga institucioni kompetent dhe përgjegjës në bazë të të cilave është lëshuar certifikata e regjistrimit të pronës dhe është bërë hipotekimi i saj.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të gjykohet se nuk ka asnjë arsye apo indice, që të jenë depozituar qëllimisht dokumente të pasakta, sepse: godina është ndërtuar ekzaktësisht mbi njollën e pronës private, janë deklaruar shpenzimet për gjendjen reale të ndërtesës dhe janë paguar detyrimet tatimore, dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore apo urbanistike për ndërtimin e godinës në gjendjen siç është ndërtuar, pra, për të menduar se ka qenë e nevojshme paraqitja e dokumenteve të pasakta.”

❖ **Arsyetimi ligjor**

- Në nenin 31, të ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularit nr. 3, që i bashkëngjitet këtij ligji, dhe paraqitet për miratim bashkë me:*
 - *Projektin teknik të objektit të hartuar nga një organizatë projektimi që e ka këtë të drejtë ose nga projektues privatë që kanë marrë licencë projektimi...*
 - *Të gjitha këto materiale përgatiten nga i interesuari dhe, së bashku me kërkesën për leje ndërtimi, paraqiten në zyrën e urbanistikës të pushtetit lokal, ku është kërkuar sheshi, e cila pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm, jep mendimin e saj dhe ia përcjell këshillit të rregullimit të territorit në rreth.”*

Ky nen përcakton qartë se projekti teknik i objektit hartohet në bazë të kërkesës së të interesuarit dhe dorëzohet në zyrën e urbanistikës nga vetë personi i interesuar që për rastin konkret rezulton të jetë investitori dhe babai i subjektit të rivlerësimit, z. N. R.

- Në nenin 12, të ligjit nr. 7720, datë 14.06.1993, “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni i urbanistikës pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit.”*

Gjithashtu, bazuar në këtë ligj është përpiluar akti i kolaudimit nr. ***, datë 07.09.1999, për objektin “Pikë karburanti”, nga ing. A. R.

- Në nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve”, i ndryshuar, që ka shfuqizuar ligjin nr. 7720, datë 14.06.1993, përcaktohet se : *““Dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni i urbanistikës pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit.”*

Me kërkesën e zotëruesit të sheshit të ndërtimit, seksioni a zyra përkatëse urbanistike i dërgon zyrtarisht zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme nën juridiksionin e së cilës ndodhet objekti, konfirmimin zyrtar të përfundimit të punimeve të ndërtimit të objektit në përputhje me ligjin, projektin dhe kushtet urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit. Këtij dokumenti i bashkëngjiten kopjet e akteve vijuese:

- leja për sheshin e ndërtimit;
- leja e ndërtimit;
- procesverbali i kolaudimit të objektit;
- leja e shfrytëzimit ose e banimit të objektit;
- plani i vendosjes së objektit;
- dokumente të tjera që përcaktojnë dhe individualizojnë objektin e ndërtuar.

Me paraqitjen e këtij dokumentacioni, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në përputhje me dispozitat ligjore, kryen veprimet përkatëse të regjistrimit të objektit dhe lëshon certifikatën e pronësisë së të interesuarit.”

Pjesë e dokumentacionit të depozituar në ZVRPP-ja Korçë për regjistrimin e objektit është edhe leja e shfrytëzimit, pa datë dhe pa nr. prot., lëshuar në bazë të nenit 12, të ligjit nr. 7720, datë 14.06.1993, e firmosur nga përgjegjësi i zyrës së urbanistikës në Këshillin e Rrethit Korçë. Ky ligj nuk parashikonte dërgimin e praktikës për regjistrim në ZVRPP-në nga vetë zyra e urbanistikës.

Në nenin 38, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, parashikohet se:

Neni 38: “Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit. Me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ. Në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, ka lidhur një kontratë qiraje ose ka vënë hipotekë në bazë të ligjit, vendimit të gjykatës apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi mbështetur në këto akte që personi i interesuar ja paraqet, bën regjistrimin duke shënuar pronar shtetin, personin fizik ose juridik që i ka kaluar e drejta e pronësisë.”

Nga verifikimi i praktikës së dërguar nga ZVRPP-ja Korçë, rezulton se të gjitha aplikimet pranë kësaj zyre për periudhën 2000 deri në 2009, janë bërë dhe firmosur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konkretisht aplikimi:

- Nr. ***, datë 17.07.2000, aplikuar nga subjekti për regjistrimin fillestar të truallit, karburantit dhe *** + ***.
- Nr. ***, datë 10.09.2008.
- Nr. ***, datë 08.06.2009.
- Nr. ***, datë 25.05.2009.

Nga verifikimi i praktikës së lejes së ndërtimit të dërguar në Komision nga Drejtoria Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan dhe ZVRPP-ja Korçë, nuk rezulton që praktika e lejes së

ndërtimit për pasurinë “Karburant dhe *** + ***” të jetë dërguar me shkresë përcjellëse nga zyra e urbanistikës së Këshillit të Rrethit Korçë. Gjithashtu, në dosje nuk rezulton ndonjë kërkesë nga personi i interesuar, z. N. R, për dërgimin nga zyra e urbanistikës të praktikës së lejes së ndërtimit për regjistrim pranë ZVRPP-së Korçë. Kjo do të thotë që praktika e lejes së ndërtimit, ku përfshihen edhe planimetritë e katit I, II dhe III, është dorëzuar nga vetë aplikuesi, në rastin konkret subjekti i rivlerësimit, si dokumentacion që shoqëron aplikimin në ZVRPP për regjistrim fillestar të pasurisë (aplikimi nr. ***, datë 17.07.2000) duke u paguar edhe tarifa përkatëse financiare sepse në të kundërt ZVRPP-ja nuk do të ishte vënë në lëvizje për regjistrimin e kësaj pasurie.

Konkluzion

- *Për sa më sipër, rezulton se ka mospërputhje të dokumentacionit tekniko-ligjor të praktikës së lejes së ndërtimit të pasurisë “Karburant dhe *** + ***”, në emër të shtetasit N. R, të ndodhur në Drejtorinë Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan, me dokumentacionin e depozituar nga subjekti në ZVRPP-në Korçë nëpërmjet aplikimit për regjistrimin fillestar nr. ***, datë 17.07.2000, për regjistrimin e kësaj pasurie ndërkohë që ai duhet të ishte i njëjtë.*

1.2 Mbi vlerën e investimit fillestar

Sipas deklaratës së pasurisë – shtojca 2, në investimin fillestar, subjekti ka deklaruar se ka kontribuar me vlerën prej 1.000.000 lekësh, që janë kryesisht pjesë e kursimeve dhe nga puna e bashkëshortit të subjektit, z. A. B, si emigrant në Greqi.

Investimi nga z. N. R, babai i subjektit dhe z. P. R, vëllai i subjektit, ka qenë në vlerën rreth 3.500.000 lekë. Z. N. R ka pasur të ardhura nga babai i tij që ka qenë emigrant në SHBA ku edhe ka vdekur, ndërsa z. P. R ka pasur kursime nga puna si emigrant në Greqi.

Znj. M. S. ka kontribuar me vlerën prej 1.000.000 lekësh.

Pra, subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, vlerën 5.500.000 lekë, në total të investuar fillimisht nga të gjithë bashkëpronarët. (ILDKPKI-ja ka konsideruar si investim fillestar nga bashkëpronarët shumën prej 9.000.000 lekësh duke përfshirë këtu edhe investimin e shoqërisë “***” prej 3.500.000 lekësh).

- Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar vlerën e investimit prej 10.000.000 lekësh.

❖ Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

- Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 30.06.2000, subjekti Irma Balli, së bashku me tre bashkëpronarët e tjerë z. N. R., z. P. R., si dhe znj. M. K., deklarojnë se pavarësisht se leja e

ndërtimit me nr. ***, datë 10.11.1997, për ndërtimin e një objekti karburant në qytetin e Korçës është dhënë vetëm në emrin e bashkëpronarit N. R, në ndërtimin e këtij objekti kanë investuar të katër në mënyrë të barabartë.

Sqarimet e dhëna nga subjekti se: *“Deklarata noteriale, datë 30.06.2000, është më shumë një dhurim që babai më ka bërë mua dhe motrës sime M, me qëllim që ne të ishin të barabartë në përfitimin e pronësisë, pavarësisht nga kontributi i secilit në vlerë monetare. Me anë të kësaj deklaratë, secili nga personat (të gjithë pjesëtarë të një familje), ka shprehur vullnetin e tij për të mos lindur asnjë konflikt në të ardhmen apo pretendime për pjesët në këtë pasuri, për çfarëdo gjë që të ndodhte.*

Të tre fëmijët e N kanë investuar pothuaj në mënyrë të barabartë, dhe që në këtë moment, nga ana e babit tim N. R, na u bë ditur se e gjithë pasuria e tij pas vdekjes do të shkonte në favor të vëllait, dhe në fakt ka ndodhur që është realizuar ky njoftim i tij, siç bëhet e ditur në testamentin e lënë dhe çelur pas vdekjes, të cilin juve e keni në depoziton, ku vërtetohet se e gjithë pasuria e baba ka kaluar në favor të vëllait dhe fëmijëve të tij të mitur”, nuk rezultojnë të jenë bindëse, ballafaquar ato me deklaratimet e vetë subjektit në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe deklaratën e pasurisë – shtojca 2, nga ku rezulton se shumata e investuara nga bashkëpronarët nuk janë të barabarta.

Konkluzion

- **Rezulton se ka mospërputhje në lidhje me vlerën e investimit fillestar në objektin e llojit “Karburant dhe *** + ***) midis: deklaratimit periodik vjetor të vitit 2003 (ku është deklaruar se shuma e investuar prek 10 milionë lekë) si dhe deklaratimit në deklaratën e pasurisë – shtojca 2 (ku shuma e investuar është deklaruar 9 milionë lekë). Të dyja këto deklarime bien në kundërshtim me deklaratën noteriale nr. ***, datë 30.06.2000, sipas së cilës të katër bashkëpronarët kanë investuar në mënyrë të barabartë, ashtu siç janë të katërt bashkëpronarë të truallit, në pjesë të barabarta, pavarësisht se si investitor del vetëm emri i baba të subjektit, z. N. R.**
- **Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues ligjor që vërteton vlerën reale të investuar në këtë pasuri, situacionet e punimeve sipas fazave, shoqëruar me likuidimet e pagesave.**
- **Në procesverbalin e kolaudit nr.***, datë 07.09.1999, për këtë pasuri, vërehet se nuk ka vlerë totale të investimit të kryer.**

1.3 Mbi ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura për kryerjen e investimit

1. Subjekti, në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, ka deklaruar si investim fillestar:
 - Vlerën prej 3.500.000 lekë, plus aksesorë si pompa, tendë reklame, etj., të dhëna nga firma “****” sh.p.k.

- Të katërt bashkëpronarët kanë kontribuar së bashku, ku pjesa më e madhe ka qenë nga babai i subjektit, i cili më pas ka investuar pjesën më të madhe të realizuar nga të ardhurat sidomos nga qiraja.
 - Në investimin fillestar subjekti ka kontribuar me vlerën prej 1.000.000 lekësh, që janë kryesisht pjesë e kursimeve dhe nga puna e bashkëshortit si emigrant në Greqi.
 - Investimi nga z. N. R, babi i subjektit, dhe z. P. R, vëllai i subjektit, ka qenë në vlerën rreth 3.500.000 lekë. Z. N. R, ka pasur të ardhura nga babai i tij që ka qenë emigrant në SHBA, ku edhe ka vdekur, ndërsa z. P. R ka pasur kursime nga puna si emigrant në Greqi.
 - Znj. M. S, trashëgimtare e vetme e familjes birësuese ***, ka kontribuar me vlerën prej 1.000.000 lekë.
2. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003 (deklarimi për herë të parë), subjekti deklaroi si burim financiar për ndërtimin e objektit:
- Kredi nga shoqëria “****” me aktin nr. ***, datë 08.06.1998 (kredi, e cila në momentin e deklarimit, deklarohet e likuiduar).
 - Kursimet e familjes.
 - Fitimet e realizuara nga shitja e karburantit.

a) Mbi burimin e shumës prej 1.000.000 lekë të investuara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, subjekti, në përgjigje të pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit sqaron se për shkak të një periudhe shumë të gjatë kohore prej 27 vjetësh, nuk disponon dokumentacion që të provojë punësimin e bashkëshortit si emigrant në Greqi dhe nuk e ka pasur detyrim ligjor për ruajtjen e dokumenteve përtej afatit ligjor 10-vjeçar. Gjithsesi, subjekti sqaron se për periudhën në fjalë i ka pasur mundësitë financiare për të krijuar likuiditete të mjaftueshme për të investuar shumën prej 1.000.000 lekësh për ndërtimin e karburantit.

Subjekti, në kuptim të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, sqaron se gjendet në pamundësi objektive për të siguruar dhe disponuar dokument justifikues, dhe për këtë arsye mendon që Komisioni duhet ta vlerësojë si shkak të arsyeshem.

❖ Arsyetimi ligjor

Pika 3, e nenit D⁴ të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 21⁵ e udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, kërkojnë nga subjektet e rivlerësimit që për të ardhurat e deklaruara, të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to.

⁴ Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj

⁵ Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklarimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë.

Konkluzion

- **Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave nga puna në emigracion e bashkëshortit, të deklaruar si një nga burimet financiare në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, për ndërtimin e pasurisë “Karburant dhe *** + ***”.**
- **Deklarimi nga ana e subjektit se nuk disponon dokumentacion që të provojë punësimin e bashkëshortit si emigrant në Greqi, nuk e mundëson zbatimin e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, sepse subjekti nuk ka provuar që të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të siguruar dhe për të disponuar një dokument justifikues.**

b) Mbi burimin e të ardhurave të investuara nga znj. M. S, në shumën 1.000.000 lekë, me përgjigjet e pyetësorit, të protokolluara pranë Komisionit me nr. * prot., datë 29.10.2018, subjekti i rivlerësimit, shpjegoi se: “Investimi në masën 1.000.000 lekë i bashkëpronares tjetër të pikës së karburantit M. S e ka burimin jo vetëm në kursimet nga të ardhurat e saj si stomatologe apo si trashëgimtare e vetme e prindërve të saj birësues por kryesisht nga të ardhurat e realizuara nga shitja e një apartamenti në Tiranë në vlerën 1.300.000 lekë, në datën 13.10.1999.**

Shlyerja e detyrimit ndaj firmës së ndërtimit është bërë me këste edhe pas datës së kolaudimit dhe ka vazhduar deri në vitin 2000”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit, vihet re se, sipas kontratës së shitjes së apartamentit nr. ***, datë 13.10.1999, z. M. S, bashkëshorti i znj. M. S, ka shitur apartamentin kundrejt vlerës 1.300.000 lekë, ndodhur në Rr. “****”, Tiranë⁶.

Në deklarimin periodik të vitit 2003 subjekti ka deklaruar se viti që është ndërtuar objekti është nëntor 1998, ndërsa kolaudimi i objektit “Pikë karburanti”, i cili ndodhet në shëtitoren “****”, Korçë, është bërë me procesverbalin nr. ***, datë 07.09.1999.

Katër bashkëpronarët kanë lidhur një aktmarrëveshje me nr. ***, datë 08.06.1998, me shoqërinë tregtare “****” sh.p.k., për investimin e vazhdimin dhe përfundimin e ndërtimit të objektit sipas projektit të investitorëve duke dhënë shumën prej 3.500.000 lekësh, *cash*, në dorë.

❖ Arsyetimi ligjor

Konkluzion

⁶ ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 24.12.2018, konfirmon kontratën e shitjes nr. ***, datë 13.10.1999, për këtë apartament.

Komisioni konstatoi se shitja e apartamentit është kryer pas përfundimit të ndërtimit të objektit “Pikë karburanti” dhe pas kolaudit të tij dhe, për rrjedhojë, shuma e përfituar nga shitja e apartamentit nuk mund të ketë shërbyer si burim të ardhurash të ligjshme për të justifikuar investimin prej 1 milionë lekë të znj. M. S në ndërtimin e objektit.

Bazuar në aktmarrëveshjen nr. *, datë 08.06.1998, e lidhur ndërmjet katër bashkëpronarëve dhe shoqërisë “****” sh.p.k., konfirmohet fakti se investimi për vazhdimin dhe përfundimin e ndërtimit pas kësaj date është kryer nga shoqëria dhe jo nga bashkëpronarët.**

Në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 21⁷ të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. *, datë 10.10.2016, subjekti nuk arriti të provojë ekzistencën e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar investimin prej 1.000.000 lekësh të znj. M. S në ndërtimin e objektit në fjalë.**

c) Mbi burimin e krijimit të të ardhurave të investuara nga z. N. R dhe z. P. R për ndërtimin e objektit, në shumën prej 3.500.000 lekësh, subjektit të rivlerësimit, në rezultatet paraprake të hetimit administrativ, i është kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor, burimin e krijimit të kësaj shume.

Në pyetësorin e protokolluar me nr. *** prot., datë 29.10.2018, pranë Komisionit, subjekti, ndër të tjera, shpjegon se: *“Lidhur me bashkëpronarët e tjerë të pikës së karburantit, z. N. R (vëllai im), sqaroj së pari se ata kanë qenë një familje dhe kontributi i tyre në vlerën prej 3.500.000 lekësh në investimin për ndërtimin e pikës së karburantit ka qenë i përbashkët. ...Babai im, z. N. R, ishte fëmijë i vetëm i P dhe Dh. R dhe ka trashëguar prej tyre të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të familjes. Ai ka punuar nga viti 1947 deri në vitin 1990 pa asnjë shkëputje dhe bashkëshortja e tij, V. R, ka punuar pa shkëputje nga viti 1960 deri në vitin 1993.*

Përveç kursimeve nga puna e tij dhe e bashkëshortes si dhe vlerave monetare të trashëguara të babait tim, z. N. R, pjesa kryesore e kursimeve të tij kanë qenë dërgesat e vazhdueshme në dollarë amerikanë për një periudhë shumë të gjatë kohe nga babai i tij emigrant në SHBA, z. P. R.

Sqaroj se P. R ka qenë emigrant në SHBA që nga viti 1915 dhe deri në kohën që vdiq në Amerikë në vitin 1962. Ai ka punuar si Chef në “Parkwasy Club” në Everett Mass dhe ka pasur të ardhura të mira.

Meqenëse, babi im, z. N. R., ka ndërruar jetë, më 07.01.2016, nuk mund të ofroj informacion të detajuar dhe të dokumentuar mbi kursimet e tij, por babai im ka pasur të ardhura të mira.

Lidhur me bashkëpronarin tjetër të pikës së karburantit vëllain tim, z. P. R., sqaroj se për periudhën e viteve 1992 – 1996, ai ka punuar si emigrant në ishullin e Kretës. Nga puna e tij ka realizuar të ardhura të mira, një pjesë e të cilave në masën 1.653.249 dhrahmi, pra, mbi 1.000.000 lekë, sipas kursit të këmbimit të asaj kohe, kanë qenë të depozituara në bankën greke “Etniki Trapeza”. Ky ka qenë edhe burimi i krijimit të tij në investimin e pronës”.

⁷Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë.

Subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit kopje të librezës së kursimit nga Banka Kombëtare e Greqisë në emër të z. P. N. R, prej vitit 1993⁸.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se: *“..Për sa i përket dokumentit librezë kursimi e vëllait tim, sqaroj se ai është një dokument origjinal i një banke private greke dhe nuk ka nevojë për vulë apostille... . Ndërsa, lidhur me kursin e këmbimit të drahmisë, të cilit i jeni referuar për të llogaritur vlerën në lekë të gjendjes prej 1.653.249 drahmi në librezën e vëllait tim, sqaroj se:*

Në deklarinimet e mija nuk është dhënë, në asnjë rast, data e këmbimit të kësaj vlerë nga ana e vëllait tim, ndërkohë që nga ana juaj është referuar apriori kursi i vitit 1994. Këmbimi i drahmive në lekë është kryer nga vëllai im në qershor të vitit 1997 dhe kursi i këmbimit nga Banka e Shqipërisë për këtë kohë ka qenë 66.370. Pra, gjendja e konvertuar në lekë është 1.097.261 lekë”.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pranoi origjinalitetin e librezës së kursimit nga Banka Kombëtare e Greqisë në emër të z. P. N. R dhe çmon se subjekti nuk ka paraqitur prova apo rrethana të reja krahasuar me ato të deklaruara apo të depozituara gjatë hetimit administrativ për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të shumës prej 3.500.000 lekësh, e investuar nga babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e objektit.

❖ **Arsyetimi ligjor**

Konkluzion

- **Komisioni vlerëson se në kuptim të pikës 3, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, ekzistenca dhe ligjshmëria e burimit të krijimit të shumës monetare prej 3.500.000 lekësh, e investuar nga babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, për ndërtimin e objektit, nuk është e provuar me dokumentacion ligjor.**
- **Nuk provohet me dokumentacion ligjor dërgimi dhe posedimi ndër vite i shumave monetare që sipas pretendimeve të subjektit, nga shtetasi P. R janë dërguar nga SHBA-ja në Shqipëri, për llogari të shtetasit N. R, për më tepër që z. P. R, ka vdekur në vitin 1962 dhe nuk është bindës shpjegimi që prej vitit 1962 mund të jenë kursyer dhe mbartur për më shumë se 30 vjet shuma të tilla parash, duke pasur parasysh edhe rrethanat sociale, politike dhe ekonomike të atyre viteve.**
- **Gjithashtu rezulton i pamundur krijimi i kursimeve nga të dy prindërit e subjektit nëpërmjet të ardhurave të tyre nga puna, për faktin se prej vitit 1993, të dy ata kanë qenë në pension dhe se pensionet në Republikën e Shqipërisë kanë qenë në vlera minimale për të mundësuar përbalimin e shpenzimeve jetike.**

⁸ Për më tepër shihni pyetësorin e protokolluar me nr. *** prot., datë 29.10.2018, pranë Komisionit.

- **Subjekti nuk ka vërtetuar me dokumentacion ligjor punësimin dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe kursimeve të vëllait të saj nga punësimi si emigrant në Greqi.**

1.4 Mbi investimin e shoqërisë “**” sh.p.k.**

- Sipas aktmarrëveshjes nr. ***, datë 08.06.1998, të lidhur ndërmjet shtetasve N. R, P. R, M. K dhe Irma Balli, si dhe shoqërisë tregtare “****” sh.p.k., kjo e fundit merr përsipër investimin e pjesës së mbetur të pikës së karburantit deri në vënien në funksionim të saj duke dhënë shumën 3.500.000 lekë, *cash*, në dorë. Pika e karburantit do të jetë filial i shoqërisë “****” në qytetin e Korçës. Fitimi do të derdhet në bankë në llogarinë e hapur nga shoqëria “****” në Bankën e Kursimit Korçë; kushti për derdhjen e fitimit do të jetë deri në deri në shlyerjen e vlerës së investuar prej shoqërisë që është investim pa interes. Interesi kupton vendosjen e reklamës dhe shitjen në emrin e tyre. Filiali do të administrohej nga z. N. R. Aktmarrëveshja ka fuqi ligjore deri në përfundimin e shlyerjes së vleftës së investuar nga shoqëria “****”.

❖ Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë të vitit 2003, subjekti deklaron si burim krijimi për karburantin kredinë nga shoqëria “****” sh.p.k., si dhe faktin se kjo kredi është e likuiduar.

Lidhur me dokumentimin e shlyerjes së shumës prej 3.500.000 lekësh shoqërisë “****” sh.p.k., nga bashkëpronarët, subjekti i rivlerësimit, më datë 10.09.2018, sqaron ndër të tjera se:

*“Me kompaninë “****” kemi lidhur një aktmarrëveshje me nr. ***, datë 08.06.1998, me anë të së cilës kjo kompani ka xhiruar në favorin e bashkëpronareve N. R, P. R., M. S dhe Irma Balli, vlerën prej 3.500.000 lekë, me qëllim përfundimin e ndërtimit të objektit "Pikë karburanti" dhe vënien në funksion të saj, duke u përcaktuar qartë edhe mënyra e vjeljes së detyrimit të sipërm në këtë aktmarrëveshje.*

*Kështu, ndërmjet të tjerash, është rënë dakord, se, "Fitimi do të derdhet në bankë, në llogarinë e hapur nga shoqëria "****", në Bankën e Kursimit Korçë. Me "fitim" kuptohet diferenca e çmimit shumicë-pakicë minus shpenzimet (paga, energji elektrike, fuqi punëtorë etj.) plus 50 % e fitimit neto.*

*Ky kusht për derdhjen e fitimit do të jetë deri në shlyerjen e vleftës së investuar prej shoqërisë “****” që është investim pa interes. Interesi kupton vendosjen e reklamës dhe shitjen në emrin e tyre.*

*Filiali do të administrohet nga z. N. R, firma e të cilit do të depozitohet në bankë. Ai do të kryejë veprimet me bankën, derdhje dhe tërheqje lekësh. Investimi nga shoqëria “****” nuk ka të bëjë me pronësinë e pikës së karburantit. Kjo aktmarrëveshje ka fuqi ligjore deri në përfundimin e shlyerjes së vleftës së investuar nga shoqëria “****”. ...marrëveshja është përfunduar me sukses në fund të vitit 2000. Kompania “****” e ka përdorur pikën e karburantit plotësisht në kushtet e kontratës së sipërme duke realizuar përfundimisht kërkesat e saj. Palët nuk kanë pasur asnjë lloj pretendimi dhe kjo vërtetohet me faktin se ndërmjet tyre nuk ka asnjë konflikt gjyqësor të ngritur.*

Zgjidhja e aktmarrëveshjes është bërë në heshtje. Nuk është lidhur kontratë tjetër bashkëpunimi”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti, ka vënë në dispozicion të Komisionit një mandat nga dega e Bankës së Kursimeve Korçë, datë 26.06.1998, me debitor firmën “****” sh.p.k., Tiranë, dhe me kreditor z. N. R Korçë, me përshkrimin, “sa kalojmë në llogarinë e personit të sipërshtënuar” me vlerën 1.000.000 lekë, që vërteton vetëm investimin prej 1.000.000 lekësh nga shoqëria “****” sh.p.k. Subjekti gjithashtu, për të provuar pamundësinë e sigurimit të dokumentacionit që vërteton kalimin e shumave monetare nga shoqëria te investitorët, ka depozituar në Komision vërtetimin nr. *** prot., datë 29.01.2019, të “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit dokumentet bankare që i përkasin viteve 1998, nuk mund të gjenden pranë arkivit të “Raiffeisen Bank”, pasi dokumentet e kësaj periudhe janë asgjësuar mbas plotësimit të afatit të ruajtjes (10 vjet), bazuar në rregulloren për arkivimin e dokumentacionit në “Raiffeisen Bank”.

Për të vërtetuar shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë nga bashkëpronarët, subjekti, ka vënë në dispozicion të Komisionit mandatarkëtime të shitjes së mallit për periudhën 1998 - 2000. Gjithashtu, për të vërtetuar marrëdhënien e mësipërme të investimit, si dhe përmbushjen e detyrimeve reciproke nga palët, shoqëria “****” sh.p.k., ka lëshuar vërtetimin, në datën 30.01.2019 (data shënuar me shkrim dore), ku konfirmohet xhirimi nga ana e shoqërisë në favor të shtetasve të mësipërm, i vlerës monetare prej 3.500.000 lekë, me qëllim përfundimin dhe vënien në funksion të objektit “pikë karburanti”, si dhe shlyerjen e detyrimeve sipas kushteve të aktmarrëveshjes nga kjo pikë karburanti gjatë viteve 1998 – 2000.

Komisioni ka kryer hetim administrativ mbi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 3.500.000 lekësh të investuar nga shoqëria “****” sh.p.k.

Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni⁹ vërehet se:

- Sipas tabelës “Inventari i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, krijuar deri në datën 31.12.1997, nga shoqëria “****” sh.p.k., fitimi i pashpërndarë për vitet 1994, 1995 dhe 1996 është në vlerën prej 32.560.100 lekësh.
- Vendim nr. ***, datë 28.04.1998, i ortakut të vetëm të shoqërisë, z. F. D., ku fitimi i pashpërndarë i vitit 1997 është në vlerën prej 1.762.121 lekësh; fitimi i pashpërndarë nga vitet e kaluara (‘94, ‘95, ‘96) në vlerën prej 32.560.100 lekësh, të bashkohet me kapitalin themeltar; detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut të vetëm në vlerën prej 12.967.965 lekësh janë krijuar që në themelimin e shoqërisë nga investimet e bëra të domosdoshme për funksionimin e shoqërisë, të bashkohen me kapitalin themeltar.
- Vendimi nr. ***, datë 02.06.1998, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “****” sh.p.k., në vlerën prej 45.528.065 lekësh.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, informon ndër të tjera se nga verifikimi në sistemin tatimor rezulton se nuk disponohen të dhëna në lidhje me pasqyrat financiare të viteve 1995, 1996, 1997, 1998, 1999, 2000 si dhe deklaratat e tatimit mbi fitimin për këto vite. Ky subjekt është aktualisht me status pasiv që nga 16.12.2014.

⁹ Shihni në dosjen e Komisionit shkresën e QKB-së, nr. *** prot., datë 12.12.2018.

Subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se: “...Në vitin 1998, shoqëria “***” ka qenë kompania më e madhe në vend, në fushën e tregtimit të hidrokarbureve, e cila na ka krijuar besimin tonë për të hyrë në marrëdhënie biznesi me të, siç është parashikuar në aktmarrëveshje...”. Gjithashtu, subjekti u bashkëlidh shpjegimeve një urdhërshirim të jashtëm të shoqërisë “***” ndaj z. N. R, më datë 28 qershor 1998, me vlerë 1.000.000 lekë nëpërmjet Bankës së Kursimeve Korçë.

❖ Arsyetimi ligjor

Konkluzion

➤ Në përfundim, Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet dhe dokumentet si më poshtë:

- i. Shpjegimet e dhëna nga subjekti në pyetësorë dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit;
- ii. Deklaratën e pasurisë së subjektit për vitin 2003;
- iii. Aktmarrëveshjen, datë 08.06.1998;
- iv. Vërtetimin nr. *** prot., datë 29.01.2019, të “Raiffeisen Bank”;
- v. Vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., datë 30.01.2019;
- vi. Urdhërshirim të jashtëm të firmës “***” ndaj z. N. R, më datë 28 qershor 1998, me vlerë 1.000.000 lekë, nëpërmjet Bankës së Kursimeve;
- vii. Mandatarkëtim (i jashtëm) i Bankës së Kursimeve që kreditojnë llogarinë e shoqërisë “***” të periudhës 1998 - 2000;
- viii. Dokumentacionin që rezulton nga korrespondenca me QKB-në,

krijoi bindjen se:

- a) Investimi i kryer nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën prej 3.500.000 lekësh, për përfundimin e objektit “Pikë karburanti” sipas projektit të investitorëve, është kryer me burime të ligjshme financiare;
- b) Shuma prej 3.500.000 lekësh, është investuar realisht nga shoqëria “***” sh.p.k.;
- c) Shuma prej 3.500.000 lekësh i është kthyer shoqërisë “***” sh.p.k., nga ana e bashkëpronarëve (ku njëri prej tyre është vetë subjekti i rivlerësimit me ¼ pjesë), në truallin e të cilëve është kryer investimi.

1.5 Mbi vlerën e pasurisë të deklaruar në deklaratën e pasurisë – shtojca 2

Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, deklaroi vlerën e pasurisë 15.960.000 lekë, për objektin “Pikë karburanti”.

Kjo vlerë është llogaritur sipas aktit të vlerësimit, datë 21.6.2016,¹⁰ të paraqitur nga subjekti. Sipas këtij akti vlera e ndërtesës *** + *** e llogaritur me kosto ndërtimi për m²= 38.000 lekë, është 120 m²*3=360 m²+60 m² papafingo=420 m²*38.000 lekë=15.960.000 lekë.

¹⁰ Shihni në dosjen e ILDKPKI-së aktin e vlerësimit nga eksperti vlerësues, z. J. S.

❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

Referuar kartelës së pasurisë¹¹, sipërfaqja e papafingos është 144.9 m², ndërsa e llogaritur në akt për 60 m²; pra, rezulton diferencë në sipërfaqen e llogaritur në këtë akt prej 84.9 m², e cila, e përkthyer në vlerë investimi është 3.226.200 lekë. Rrjedhimisht, vlera totale e objektit me kosto ndërtimi është 19.186.200 lekë, pa përfshirë këtu vlerën e mobilimit të ** kateve plus papafingo.

Komisioni konstatoi se vlerësimi i kryer nuk tregon vlerën e vërtetë të objektit, pasi vlerësimi i papafingos është bërë për sipërfaqen 60 m², ndërkohë që sipërfaqja e papafingos, sipas dokumentacionit të ZVRPP-së Korçë, dhe ALUIZNI-t Korçë, është 144.9 m².

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se: *“Sipërfaqja prej 144,9 m² referuar kartelës së pasurisë me nr. pasurie ***, zk. ***, mbështetur në certifikatën e pasurisë të datës 15.02.2016, nuk ishte e përcaktuar sipërfaqja e papafingos prej 120 m² dhe nuk ishte marrë prej tij kartela e re, ku në zërin “përshkrim i veçantë” të specifikohet sipërfaqja e legalizuar në papafingo. Në fakt nga njohja me kartelën sipërfaqja e shtuar është 12.5 m². Nga ana e ekspertit nuk është bërë përllogaritja për sipërfaqen pasi nuk ishte në dispozicion të tij titulli i ri i pronësisë.*

Në lidhje me sip. prej 60 m², që i është zvogëluar pjesës së papafingos në momentin e kryerjes se vlerësimit, në fakt eksperti pretendon që nga ana e tij nuk është zvogëluar sipërfaqja, por duke qenë se në udhëzimet përkatëse në momentin e vlerësimit në rastet e papafingove vlera që ka papafingo është sa 1/2 e vlerës së apartamentit të banimit, (sepse sip. në m³ që ndodhet në një papafingo është sa 1/2 e sip. së apartamentit të banimit). Vlerësimi nga ana e tij është bërë edhe për papafingon me 38.000 lekë m², por duke vënë gjysmën e sipërfaqes së ndërtuar. Ky veprim nuk mund të cilësohet si gabim vlerësimi në lidhje me vlerën totale, por është gabim interpretimi, sepse ai duhet të shënonte 120 m² sipërfaqe papafingo, duke i dhënë vlerën 19.000 lekë/m², kur në vlerë totale nuk kemi ndryshime prej vlerës 15.960.000 lekë”.

❖ **Arsyetimi ligjor**

Konkluzion

- **Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se, sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 22.12 2015, sipërfaqja totale e ndërtimit për banim është 132.4 m² dhe sipërfaqja e shtesës së legalizuar është 12.5 m², shpjegimet e dhëna nga subjekti se sipërfaqja e papafingos, sipas udhëzimeve përkatëse, është marrë sa gjysma e sipërfaqes së katit, duke ruajtur të pandryshuar çmimin lekë/m², sipërfaqja ndërtimore sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 16.12.2011, është 120 m², çmon se në përcaktimin e vlerës totale të investimit nuk është llogaritur vlera për sipërfaqen e legalizuar prej 12.5 m², si dhe rezulton një sipërfaqe prej 12.4 m² (144.9m² – (120+12.5) = 12.4m²), e pambuluar me dokumentacion justifikues ligjor dhe e pallogaritur në vlerën totale të**

¹¹ Shihni në dosjen e Komisionit shkresën, nr. *** prot., datë 13.02.2018, të ZVRPP-së Korçë.

investimit. Pra, kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaram në lidhje me sipërfaqen reale dhe me vlerën totale të investuar për ndërtimin e objektit në fjalë.

1.6 Mbi ndërtimin e shtesës në lartësi

❖ Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Gjatë hetimit administrativ, Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë, me shkresën nr. ***, datë 20.02.2018, bën me dije se nga verifikimi, znj. Irma Balli rezulton aplikues me vetëdeklarim për ndërtim informal të ndodhur në Korçë.

Me lejen e legalizimit nr. ***, datë 22.12.2015, është bërë legalizimi për objektin “Shtesë anësore e papafingos (kati i tretë) në objekt të regjistruar” në emër të z. P. R + bashkëpronarë, me sip. 12.5 m².

Sipas deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim pa leje nga N. R., P. R, M. K, Irma N. Balli ndërtimi është ngritur në vitin 2008.

Sipas planimetrisë së papafingos (kati i tretë) sip. ndërtimi 144.9 m² (sip. shtesës 12.5 m²) (sip. Banimi 144.9 m² +sip. funks. Soc-eko m²). Në praktikën e lejes së legalizimit nuk ka asnjë dokument që të tregojë pozicionimin hartografik të sipërfaqes së legalizuar.

Sipërfaqja ndërtimore sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. *, datë 16.12.2011, është 120 m², sipërfaqja e legalizuar është 12.5 m² ndërsa sipërfaqja totale e papafingos është 144.9 m², çka do të thotë se mbetet e pajustificuar me dokumentacion ligjor sipërfaqja prej 12.4 m².**

Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar ndërtimin e objektit në lartësi në deklaratën periodike të vitit 2008, si edhe vlerën e këtij ndërtimi dhe burimin e ligjshëm financiar. Gjithashtu ka dyshime të arsyeshme për mospërputhje të sipërfaqes reale të objektit, në fakt, me atë të mbështetur në dokumente ligjore përfshirë edhe sipërfaqen e papafingos.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se: *“Nuk mund të flitet për “fshehje” të sipërfaqes reale të objektit. Diferenca prej 12.5 m², që përbën vetëm 2 % të sipërfaqes totale të objektit nuk mund të justifikojë asnjë qëllim “fshehje” të pronës. Ajo pjesë e objektit që është ndërtuar në vitin 2008, ka një vlerë minimale. Shpenzimi i bërë ka qenë nën kufijtë e vlerës detyrim për t’u deklaruar.*

Deklarata “Vetting” pasqyron sipërfaqen reale të papafingos, pasi kishte përfunduar procesi i legalizimit që i takon vitit 2015. Në këtë moment është bërë dokumentimi ligjor i faktit. Për këtë arsye për këtë ndryshim që do të pasqyrohet edhe në kartelën e pasurisë, deklarimi është bërë në atë vit të deklaratës vjetore periodike 2015 dhe jo për vlerën e ndërtimit apo shpenzimin e kryer e cila siç kam shpjeguar ka qenë minimale.

Legalizim është kryer, pasi janë bërë verifikimet në terren nga specialistet e ALUIZNI-t në përputhje me dokumentacionin e objektit.

Si në certifikatën e pronësisë ashtu edhe në të gjitha aktet e tjera që lidhen me këtë pronë, sipërfaqja e trualli është 170 m², ndërsa sipërfaqja ndërtimore e objektit (njolla) është 120 m². Nuk ka mospërputhje me sipërfaqen e pronës në dokumente dhe në atë faktike”.

❖ **Arsyetimi ligjor**

Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2008, në faqen nr. 3, duhet të deklarohen ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme e të luajtshme: *“Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve, vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie të paluajtshme apo të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit”.*

Në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: *“Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji.”*

Për legalizimin e ndërtimeve pa leje, ku përfshiheshin edhe shtesat anësore në objektet ekzistuese, ligjvënësi miratoi një paketë të plotë ligjore, konkretisht ligjin nr. 9304, datë 28.10.2004, “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale” dhe ligjin nr. 9209, datë 23.03.2004, “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, të cilat më vonë u kombinuan në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Ndërtimi pa leje i shtesës anësore nga subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë, në bazë të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”, është parashikuar si kundërvajtje administrative dhe nuk përbën vepër penale në bazë të legjislacionit në fuqi në kohën e ndërtimit.

Sipërfaqja ndërtimore e përcaktuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. *, datë 16.12.2011, është 120 m².**

Sipas lejes së legalizimit nr. *, datë 22.12 2015, sipërfaqja totale e ndërtimit, për banim është 132.4 + 12.5 m², ku sipërfaqja e shtesës së legalizuar është 12.5 m².**

Për sa më sipër, rezulton:

- **Mosdeklarim i sipërfaqes së legalizuar prej 12.5 m² në vitin e ndërtimit të saj.**
- **Mosdeklarim i sipërfaqes reale të papafingos në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, ku përveç sipërfaqes së legalizuar prej 12.5 m² rezultojnë edhe 12.4 m² të pajustificuara me dokumentacion ligjor, për rrjedhojë kemi të bëjmë me një deklarim të pamjaftueshëm.**

1.7 Mbi të ardhurat nga qiraja

Sipas deklaratës së **pasurisë – shtojca 2**, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 4.978.425 lekë, sipas deklaratave periodike të pasurisë, të ardhurat nga qiraja rezultojnë në shumën 4.446.425 lekë, ndërsa sipas *DIVA-së*, janë deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 4.437.898 lekë.

Komisioni konstatoi mospërputhje ndërmjet deklarimeve të të ardhurave nga qiraja përkatësisht në *DIVA*, deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së, si dhe deklaratës “Vetting”.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, ndër të tjera ka sqaruar se: *“Në deklarin DIVA, vlera e të ardhurave prej 4.437.898 lekësh i referohet periudhës nga viti 2012 deri në 08.11.2016, atëherë kur kam filluar të deklaroj pranë institucioneve tatimore.*

*Në deklaratën “Vetting”, vlera e të ardhurave prej 4.978.425 lekësh përfshin edhe të ardhurat e vitit 2011. Sjell në vëmendje se kontrata e qirasë me subjektin “***” sh.p.k., është lidhur në datën 17.03.2011 dhe transaksioni i parë i pagesës së qirasë është kryer në datën 06.05.2011. Ky fakt vërtetohet nga kontrata e qirasë, nr. ***, datë 17.03.2011, me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe nga statement bankar për klientin P. R., të cilat po i dërgoj, bashkangjitur.*

Lidhur me diferencën e vlerës prej 8.527 lekësh midis vlerave të deklaruara në DIVA dhe në deklaratat periodike, gjykoj se kjo diference e vogël është gabim në veprimet aritmetikë dhe që mund të justifikohet me parashikimet e neneve 21, 24 dhe 25, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive...””.

- *Komisioni, pasi verifikoi dokumentacionin justifikues dhe shpjegimet e subjektit, i vlerësoi ato si të plota dhe bindëse.*

1.8 Mbi të ardhurat dhe detyrimet tatimore nga dhënia me qira e karburantit

❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

Komisioni kreu hetim mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e objektit “pikë karburanti” për periudhën 2012 - 2016.

1. Kontratë qiraje nr. ***, datë 17.03.2011, midis palëve qiradhënës N. R, P. R., M. K dhe Irma Balli, përfaqësuar nga z. A. B., dhe qiramarrës shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga z. A. B., me objekt dhënien me qira pikës e tregtimit të karburantit. Afati i kontratës është 5 vjet dhe qiraja është 350.000 lekë në muaj, ndërsa pagesa e qirasë do të bëhet me xhirim në llogari të qiradhënësit.

Nga informacioni i ardhur nga “Raiffeisen Bank” rezulton se për periudhën 06.05.2011 deri në 30.09.2011, në llogari të shtetasit P. R., ka kaluar vlera neto e qirasë nga shoqëria “****” **sh.p.k.**, pasi në kontratë qiraja mujore për këtë periudhë është në vlerën 350.000 lekë, ndërsa në bankë pagesa e qirasë për periudhën e sipërpërmendur është në vlerën 315.000 lekë/muaj

(350,000-10%). Në datën **13.10.2011**, si e ardhur nga qiraja, depozitohet në llogari të z. P. R. shuma prej **350.000 lekë**, ndërsa për periudhën nëntor 2011 e deri në fund të kontratës me këtë shoqëri në llogari të z. P. R. kalon shuma prej 315.000 lekësh. Në kontratën e lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k., thuhet shprehimisht se detyrimin e pagimit të tatimit mbi qiratë e ka qiradhënësi.

2. Kontratë qiraje nr. ***, datë 25.11.2013, e lidhur midis palëve qiradhënëse N. R, P. R, M. K dhe Irma Balli, përfaqësuar nga z. A. B., dhe qiramarrës shoqëria “***” sh.p.k., me përfaqësues ligjor. z. I. S., për dhënien e karburantit me qira për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 01.08.2013 deri në datën 30.07.2018, me qira:

- Nga data 01.08.2013 – 30.09.2013, do të jetë 350.000 lekë/muaj;
- Nga data 01.10.2013 – 30.03.2014, do të jetë 300.000 lekë/muaj;
- Nga data 01.04.2014 deri në përfundim të kontratës do të jetë 350.000 lekë/muaj.

Me deklaratën e datës 19.09.2014 është revokuar kontrata e qirasë e datës 15.11.2013 të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k.

Nga informacioni i ardhur nga “Raiffeisen Bank” rezulton se, në datën **09.08.2013**, në llogari të shtetasit P. R ka kaluar shuma prej **700.000 lekë (shuma bruto e qirasë)** me përshkrimin “qira”, viti 2013, nga shoqëria “***” sh.p.k., dhe në kontratë specifikohet se qiraja mujore për periudhën **01.08.2013 - 30.09.2013 është në vlerën 350.000 lekë**, por në derdhjen e kryer në bankë nuk specifikohet se cilës periudhë i takon kjo pagesë qiraje. Në kontratë, ndër të tjera, cilësohet se për periudhën 01.04.2014 deri në fund të periudhës, vlera e qirasë mujore do të jetë 350.000 lekë. Në kontratën e lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k., thuhet shprehimisht se, detyrimin e pagimit të tatimit mbi qiratë e ka qiradhënësi.

3. Kontrata e qirasë nr. ***, datë 20.10.2014, midis palëve qiradhënëse N. R, P. R, M. K dhe Irma Balli, përfaqësuar nga z. A. B dhe qiramarrës shoqëria “***” sh.p.k., përfaqësuar nga z. G. G., me objekt, dhënien me qira të pikës së tregtimit të karburantit të përbërë prej: **sipërfaqja totale 50 m², stacion karburanti, si dhe ndërtesa me sip. 34 m² që do të përdoret si zyra nga punonjësit e qiramarrësit.** Afati i kontratës është 7 vjet dhe qiraja është në vlerën prej 388.889 lekësh në muaj, e cila do të bëhet me xhirim në llogarinë e z. P. R., në “Raiffeisen Bank”.

Nga informacioni i ardhur nga “Raiffeisen Bank” rezulton se, në datën 09.12.2014, në llogari të shtetasit P. R. ka kaluar nga shoqëria “***” sh.p.k., shuma prej 146,773.8 lekësh si qira, ndërsa në datat 16.12.2014 dhe 06.01.2015, ka kaluar si e ardhur nga qiraja shuma prej 350.000 lekësh. Nga shkurti i vitit 2015 deri në fund të periudhës, vlera e qirasë mujore e depozituar në “Raiffeisen Bank” në llogari të shtetasit P. R. është 330.556 lekë (vlera mujore e qirasë e përcaktuar në kontratë 388.889 lekë – 15 % vlera e tatimit mbi qiranë). Në kontratën me “***” sh.p.k., pagesa mujore e qirasë nga kjo shoqëri është 388.889 lekë dhe qiramarrësi do të zbresë nga shuma e qirasë mujore çdo tatim të aplikueshëm, duke e mbajtur atë në burim dhe derdhur pranë organeve tatimore.

Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratën “Vetting” vërtetimin nr. ***, datë 13.01.2017, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ku vërtetohet se personi fizik/juridik “****” sh.p.k., nuk ka asnjë detyrim tatimor për periudhën deri në datën 18.01.2017.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.02.2018, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, nuk ka detyrime tatimore.

Nga analiza e kontratave rezulton se në kontratat e lidhura me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe me shoqërinë “****” sh.p.k., detyrimin e pagimit të tatimit mbi qiratë e ka qiradhënësi, ndërsa me shoqërinë “**** Albania” sh.p.k., sipas kontratës së qirasë, qiramarrësi do të zbresë nga shuma e qirasë mujore çdo tatim të aplikueshëm mbi të ardhurat personale nga qiraja që lindin si detyrim qiradhënësit, ose çdo mbajtje në burim, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi në momentin e kryerjes së pagesës, duke e mbajtur atë në burim dhe derdhur pranë organeve tatimore përkatëse.

Nga informacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, informon se për tatimpaguesin “****” sh.p.k., nuk ka kontrata për qiranë dhe asnjë dokumentacion të saktë për llogaritjen e detyrimeve sipas kontratave, ndërsa Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj dërgon informacion mbi pagesat e qirasë për vitet 2010 dhe 2011, si dhe për disa muaj në vitin 2014, por pa specifikuar se për cilat qira janë kryer këto pagesa.

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresën nr. ***, datë 21.12.2018, dërgon informacionin se, subjektit “****” sh.p.k., i është kontrolluar dhe rivlerësuar deklarata e tatimit në burim për rubrikën “Pagesat për qiratë” për periudhën e mësipërme në dhjetor 2014, dhe ka dalë me detyrim për të paguar në shumën 4.570.250 lekë. Subjekti nuk e ka paguar këtë detyrim.

Për subjektin “**** Albania” sh.p.k., është përcjellë informacioni se ka deklaruar deklaratën e tatimit në burim për periudhën dhjetor 2014 – nëntor 2016 në rubrikën pagesat për qiratë dhe ka paguar shumën 33.792.188 lekë. Pagesat e kryera nga shoqëria janë në total për të gjitha objektet me qira dhe nuk mund të specifikohen pagesat e tatimit në burim për kontratat.

Komisioni konstatoi se, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nuk vërtetohet pagesa e plotë e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e objektit “pikë karburanti”, sipas kontratave të qirasë dhe të dhënave bankare.

Pas kalimit të barrës së provës dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti:

Në analizën financiare përfundimtare, pas seancës dëgjimore, nuk është përfshirë në të ardhurat nga qiraja shuma e depozituar bruto në tetor të vitit 2011, pasi kjo shumë është kaluar bruto në llogari të vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe nga subjekti nuk është vërtetuar pagesa e tatimit në burim në lidhje me këtë të ardhur.

Në shpjegimet e tij, subjekti e ka pranuar faktin që ekzistojnë paqartësi dhe parregullsi lidhur me pagesën e detyrimit tatimor nga shoqëritë huamarrëse, por ka pretenduar se nuk mund të ngarkohet subjekti me përgjegjësinë për të provuar rregullsinë e veprimeve apo mosveprimeve

të shoqërive qiramarrëse, dhe se pagesa e detyrimeve tatimore ka qenë përgjegjësi e shoqërive qiramarrëse.

Vetë subjekti ka depozituar një tabelë përmbledhëse të pagesave të qirasë, ku në kolonën e derdhjeve në bankë rezulton se për periudha të caktuara kohore (një dhe disa mujore në vitet 2011, 2013 dhe 2014) janë derdhur në llogarinë e vëllait të subjektit qiraja mujore përkatëse në vlerë bruto duke mos u vërtetuar kështu pagesa e detyrimit tatimor për të ardhurat nga qiraja. Kjo sjell si pasojë që analizat financiare për vitet 2011, 2013 dhe 2014, pas rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit të rezultojnë si më poshtë:

Përshkrimi	2011
Të ardhurat	3,696,446
Nga pagat dhe shpërblimet, subjekti	1,401,141
Nga pagat, bashkëshorti	1,720,000
Të ardhura nga biznesi	24,055
Të ardhura nga qiraja	551,250
Shpenzime	2,714,803
Shpenzime jetese	1,350,000 ¹²
Shpenzime shkollimi për fëmijët	842,350
Shpenzime udhëtimi	402,453
Shpenzime për fondin e pensioneve	120,000
Pasuri	1,947,444
Njësi e blerë në vitin 2011	1,000,000
Kursime (Gjendje në fund-gjendje në fillim)	947,444
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-965,801

- ❖ **Konstatim:** sipas analizës financiare për vitin 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë njësi, si dhe për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2011 duke rezultuar me një balancë financiare të ardhura – shpenzime, negative prej **-965.801 lekësh**.

Viti 2012 (mbetet e pandryshuar)

Përshkrimi	2012
Të ardhurat	3,608,770
Nga pagat dhe shpërblimet, subjekti	1,511,720
Nga pagat, bashkëshorti	1,230,800
Të ardhura nga qiraja e karburantit	866,250
Shpenzime	2,178,079

¹² Të deklaruara nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2011, shpenzime jetese etj., në shumën 1.350.000 lekë.

Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	775,857
Shpenzime shkollimi për fëmijët ¹³	778,740
Pagesë tatimi për rivlerësim apartamenti	70,350
Shpenzime udhëtimi	433,132
Shpenzime për fondin e pensioneve	120,000
Pasuri	1,610,927
Kursime (Gjendje në fund-gjendje në fillim)	1,610,927
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-180,236

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar që në vitin 2012 t'i përfshihen tek të ardhurat edhe shuma prej 420.000 lekësh e përftuar nga bonuset e karburantit, por nuk solli asnjë provë apo konfirmim për shumën e shpenzuar nga ky bonus i përftuar, apo për shumën e kursyer, dhe duke qenë se bonusi i karburantit jepet me një destinacion të caktuar për t'u shpenzuar dhe subjekti nuk ka informacion lidhur me shpenzimin e bonusit të karburantit, i cili është konsideruar i shpenzuar dhe nuk mund të konsiderohet si e ardhur në analizën financiare.

Konstatim: Në bazë të analizës financiare për vitin 2012 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2012, në shumën prej **180.236 lekësh**.

Viti 2013

Përshkrimi	2013
Të ardhurat	3,102,675
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,416,973
Nga pagat bashkëshorti	1,070,420
Të ardhura nga qiraja e karburantit	551,250
Nga interesat e depozitave	64,032
Shpenzime	1,659,977
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	775,857
Shpenzime shkollimi për fëmijët ¹⁴	430,420
Shpenzime udhëtimi	333,700
Shpenzime për fondin e pensioneve	120,000
Pasuri	1,594,864
Kursime (Gjendje në fund-gjendje në fillim)	1,594,864
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-152,166

¹³ Shuma 4.500 euro e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012, plus 150.000 shpenzime qiraje të deklaruara në përgjigje të pyetësorit.

¹⁴ Shuma 2.000 euro e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013 plus 150.000 shpenzime qiraje të deklaruara në përgjigje të pyetësorit.

- ❖ Sipas analizës financiare për vitin 2013, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera, si dhe për të justifikuar shtesën në kursimet e deklaruara përgjatë vitit 2013. Rezulton e pambuluar nga burime të ligjshme shuma prej **-152.166 lekësh**.

Viti 2014

Përshkrimi	2014
Të ardhurat	2,897,468
Nga pagat dhe shpërblimet, subjekti	1,516,821
Nga pagat, bashkëshorti	952,315
Nga interesi i depozitave	73,639
Nga qiraja	354,693
Detyrime	140,000
Kredi bankare në BKT, djali i subjektit	140,000
Shpenzime	2,006,835
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	775,857
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	31,307
Shpenzime për krijimin e një fondi privat pensionesh	120,000
Shpenzime për investime në objekt ¹⁵	86,250
Shpenzime udhëtimi	993,421
Pasuri	1,241,876
Kursime (Gjendje në fund-gjendje në fillim)	1,241,876
Të ardhura +detyrime- shpenzime – pasuri	-211,234

- ❖ Sipas analizës financiare për vitin 2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2014. Rezulton e pambuluar nga burime të ligjshme shuma prej **-211.234 lekësh**.

Në analizën financiare të vitit 2014 janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimeve sipas deklarimeve të subjektit.

2. Depozitë bankare te “BKT”-ja, dega Korçë, viti 2014. Burimi: kursimet. Vlera: 3.000.000 lekë. Zotëron: 50 %.

- ❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

¹⁵ ¼ e shumës prej 345.000 lekësh është pjesa takuese e investimit në objekt që duhet t’i ngarkohet subjektit të rivlerësimit si shpenzim për vitin 2014.

Banka Kombëtare Tregtare (BKT), me shkresën nr. *** prot., datë 16.02.2018, e konfirmon këtë depozitë. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme për krijimin e saj.

➤ Komisioni konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti është në përputhje me të dhënat e përcjella nga “BKT”-ja.

3. Depozitë bankare në “NBG”, dega Korçë, viti 2016. Burimi: kursimet. Vlera: 2.000.000 lekë. Zotëron: 100%.

❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

Banka Kombëtare e Greqisë (NBG), me shkresën nr. *** prot., datë 31.01.2018 e konfirmon këtë depozitë. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka pasur të ardhurat për krijimin e saj.

➤ Komisioni konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti është në përputhje me të dhënat e përcjella nga “NBG-ja” .

4. Interesa bankarë nga depozita në “BKT”. Vlera: 354.371 lekë. Zotëron: 50%.

❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

“BKT”-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 16.02.2018, e konfirmon këtë depozitë.

➤ Komisioni konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti është në përputhje me të dhënat e përcjella nga “BKT-ja”.

5. Kursime *cash* me burim të ardhurat në shumën 1.500.000 lekë.

❖ **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2016.

Përshkrimi	2016
Të ardhurat	4,985,956
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,543,292
Nga pagat - bashkëshorti	1,234,729
Të ardhura nga biznesi	534,428
Nga pagat - djali i subjektit	586,309
Nga interesi i depozitave	211,224
Nga qiraja	875,975

Detyrime	320,000
Kredi bankare në BKT - djali i subjektit për pushime	170,000
Kredi bankare në Union Bank - djali i subjektit për kompjuter	150,000
Shpenzime	1,484,576
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	775,857
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	85,547
Shpenzime për investime në objekt ¹⁶	60,000
Shpenzime udhëtimi	526,200
Pasuri	0
Kursime (gjendje në fund - gjendje në fillim)	0
Të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri	3,821,380

Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pikë.

6. Deklarimet e personit të lidhur me subjektin, z. A. B, bashkëshorti i subjektit.

→ Në deklaratën e pasurisë – shtojca 2, personi i lidhur me subjektin, z. A. B., bashkëshorti i subjektit, deklaroi këto pasuri:

1. Apartament banimi me sipërfaqe të përgjithshme 179 m² (përfituar nga bashkimi i dy apartamenteve), ndodhur në lagjen *, Rr. “Dh. D.”, pallat i ri, blerje e përfunduar në vitin 2004, me vlerë prej 6.000.000 lekësh. Firmës shitëse i janë paguar vlerat 4.600.000 lekë dhe 1.400.000 lekë, me të cilat është përfunduar ndërtimi i apartamentit, sipas marrëveshjes paraprake me firmën shitëse. Zotëron: 100%.**

Burimi i krijimit:

- Vlera 20.000 euro, kredi në vitin 2001, te “FEFAD Bank” (e shlyer);
- Vlera 600.000 lekë përfituar nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me familjen Balli (P, I, A, A dhe Irma Balli), sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 21.11.2003;
- Vlera 1.000.000 lekë, dhënë hua, tashmë falur nga prindërit, P dhe I. B me burim: 600.000 lekë nga shitja e apartamentit të sipërcituar dhe të ardhura nga kursimet dhe shitja e disa pronave nga I. B;
- Vlera 1.400.000 lekë me burim: kursime nga të ardhurat. Rivlerësuar me ligjin nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për amnistinë fiskale”, vlera: 11.636.000 lekë.

❖ Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

¹⁶ 1/4 e shumës prej 240,000 lekësh është pjesa takuese e investimit në objekt që duhet t’i ngarkohet subjektit të rivlerësimit si shpenzim për vitin 2016, e deklaruar në përgjigje të pyetësorit të dërguar pranë Komisionit në datën 11.01.2019.

ZVRPP-ja Korçë¹⁷ përcjell pranë Komisionit informacionin se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. B, figuron pronar i pasurisë apartament me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 98 m², e ndodhur në Korçë, si dhe pronar i pasurisë apartament me nr. pasurie *** me sipërfaqe 81 m², Korçë.

Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 08.09.2004, z. A. B, i ka blerë shoqërisë “****” një apartament banimi me sip. 98 m², në vlerën prej 2.500.000 lekësh.

Me kontratën nr. ***, datë 08.09.2004, z. A. B, i ka blerë shoqërisë “****”, një apartament banimi me sip. 81 m², në vlerën prej 2.100.000 lekësh.

1.1 Mbi burimet e ligjshme financiare për blerjen e apartamentit

“ProCredit Bank”¹⁸ konfirmon kontratën e kredisë për shumën prej 20.000 eurosh, e mbyllur në datën 27.08.2008. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën “Vetting”, kontratën nr. ***, datë 11.09.2002, lidhur me “FEFAD Bank”, me objekt marrjen e kredisë në shumën prej 20.000 eurosh me destinacion: blerje shtëpie dhe afat 72 muaj, me kësht mujor 365 euro/muaj.

ZVRPP-ja Korçë¹⁹ përcjell kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 21.11.2003, ku shitësit P, I, A, A dhe Irma Balli kanë shitur apartamentin me sip.70.4 m², në Rr. “****”, Korçë, në shumën prej 1.500.000 lekësh. Ky apartament ishte përfituar me kontratën për privatizimin e banesës së vitit 1993 me Ndërmarrjen Komunale Banesa, Korçë.

Për të vërtetuar dhënien e shumës prej 1.000.000 lekësh nga nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. I. B, është paraqitur nga subjekti deklarata noteriale e datës 24.10.2016, sipas së cilës znj. I. B, së bashku me bashkëshortin e saj, z. P. B, i cili ka ndërruar jetë, ia kanë dhuruar djalit të tyre, z. A. B, këtë shumë në vitin 2003. Kjo vlerë është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004.

Duke marrë shkas nga mospërputhja kohore: midis kohës së kryerjes së transaksionit (i deklaruar si i kryer në deklaratën noteriale të datës 24.10.2016, në vitin 2003) dhe deklarimit të dhënies së shumës prej 1.000.000 lekësh nga subjekti në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004, subjekti i kaloi barra e provës për deklarim të rremë të kësaj shume në vitin 2004 dhe për balancën financiare negative për vitin 2004 në shumën prej 349.218 lekësh, duke mos u përfshirë në analizën financiare shuma prej 1.000.000 lekësh.

Pas kalimit të barrës së provës, në shpjegimet e tij, subjekti deklaron: *“Nuk ka mospërputhje mes deklarimit tim lidhur me kryerjen e transaksionit në vitin 2004 dhe përmbajtjes së deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.10.2016, në të cilën, përveçse gabimit material, konkretisht “2003” në vend të “2004”, përmbajtja e deklaratës përcakton të shprehur saktë kohën e kryerjes së transaksionit. Po citoj shprehimisht paragrafin e deklaratës: “Këtë shumë,*

¹⁷ Shihni në dosjen e Komisionit shkresën nr. ***, datë 13.02.2018.

¹⁸ Shihni në dosjen e Komisionit, shkresën nr. prot.: *** prot., datë 15.02.2018.

¹⁹ Shihni në dosjen e Komisionit, shkresën nr. ***, datë 13.02.2018.

deklaruesja deklaron se ia ka dhënë djalit të saj në vitin kur ai ka lidhur kontratë shitblerjeje për blerjen e një apartamenti, ku ata jetojnë së bashku”.

*Në mbështetje të këtij deklarami vjen prova shkresore, që është kontrata e shitblerjes së apartamentit nr. ***, kryer në datë 08.09.2004 me të gjithë përmbajtjen e saj.*

*Fakti që znj. I. B i jeton së bashku me ne, që nga viti 2003, mbështetet te vërtetimi nr. *** prot., datë 29.01.2019 i Bashkisë Korçë, të cilin e kam kërkuar të merret si provë nga ana juaj.*

Pra, duket nga sa më sipër, se nuk ka deklarim të rremë lidhur me transaksionin dhe vlera prej 1.000.000 lekësh është e vërtetë dhe ka burim të ligjshëm, pra, është edhe e ardhur e familjes sime për vitin 2004.

Në tabelën financiare të paraqitur nga ana juaj, nuk është pasqyruar vlera prej 1.200.000 lekësh si e ardhur vjetore nga pika e karburantit, ku bashkëshorti im ka qenë ortak në biznes. Theksoj se kjo vlerë nuk është vënë në diskutim nga ana juaj në analizën pas hetimit administrativ të kriterit të pasurisë.

Në masën e të ardhurave vjetore të mia, paga, e shprehur me vlerën prej 1.336.273 lekësh rezulton një pasaktësi, jo për fajin tuaj, por si një gabim veprimi i financieres së Prokurorisë. Por të ardhurat e mia reale për vitin 2004 janë: paga: 1.134.294 lekë; orë jashtë orarit: 370.944 lekë; shpërblime: 30.000 lekë, dieta: 98.200 lekë, pra, gjithsej: 1.633.438 lekë.

Në mbështetje të këtij argumenti vjen informacioni në fletën e librit të pagës për vitin 2004, dalë nga arkivi i Prokurorisë së Apelit, Korçë.

Lidhur me shpenzimet e jetesës sipas ILDKPI-së, konstatoj se ato janë llogaritur të njëjta, si për vitet 2003 dhe 2004, ashtu edhe për vitin 2012, pavarësisht nga faktorët e ndryshuar ekonomikë e sociale, moshë e fëmijëve etj., megjithëse sipas ILDKPI-së shpenzimet për këtë periudhë kohore janë parashikuar në masën 438.228 lekë për një familje me 4 anëtarë, siç jam edhe unë, duke i rënduar shpenzimet e mia.

Në përfundim, konkludohet se të ardhurat e mia dhe të bashkëshortit tim kanë qenë të mjaftueshme për të kryer shpenzime, për të krijuar pasuri, si dhe për të realizuar kursime.”

❖ Arsyetimi ligjor

Konkluzion

Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.10.2016, të shtetases I. B, është shprehur në mënyrë të qartë fakti se deklaruesja këtë shumë ia ka dhënë djalit të saj në vitin kur ai ka lidhur kontratë shitblerjeje për blerjen e një apartamenti, ku ata jetojnë së bashku me familjen e djalit.

Të dyja kontratat e shitblerjes së apartamenteve, me blerës personin e lidhur me subjektin, z. A. B, janë lidhur në datën 08.09.2004.

Shuma prej 1.000.000 lekësh, dhënë nga shtetasja I. B djalit të saj, z. A. B, është deklaruar nga ana e subjektit në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004.

Me kontratën nr. ***, datë 08.09.2004, z. A. B, i blen shoqërisë “***”, një apartament banimi me sip. 81 m² në vlerën prej 2.100.000 lekësh.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga ana e subjektit, ato konsiderohen bindëse nga ana e Komisionit për të vërtetuar faktin se shuma prej 1.000.000 lekësh i është dhënë personit të lidhur me subjektin, z. A. B, nga e ëma e tij, znj. I. B, pikërisht në vitin 2004, kur janë lidhur dy kontratat e shitblerjes të të dy apartamenteve me firmën e ndërtimit dhe kur janë deklaruar nga ana e subjektit në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004.

Analiza financiare e vitit 2004 është pasqyruar në faqen 32.

1.2 Mbi arredimin e apartamentit

❖ Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Në pyetësorin e parë subjekti ka deklaruar se arredimi i apartamentit është kryer në vitin 2002, pjesërisht i ri, pjesërisht i trashëguar nga apartamenti i mëparshëm, duke deklaruar si vlerë arredimi shumë prej 1.500.000 lekësh.

Mbi këtë investim subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor që justifikon pajisjet e blera dhe vlerën e investuar. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në vitet 2003 - 2004 ka kryer punime që konsistonin në pajisjen e apartamentit me suva të brendshme, dyer të brendshme, pllaka dysHEMEJE, parket dhe hidrosanitare banjash, në vlerën prej 1.400.000 lekësh, punime thelbësore këto që një apartament të jetë i banueshëm.

Duke marrë shkas nga deklaratimet e subjektit, se në vitet 2003-2004 ka qenë duke kryer punime në apartament, Komisioni i ka kërkuar përsëri sqarime subjektit për të saktësuar vitin e saktë të arredimit të shtëpisë.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar pranë Komisionit, në datën 15.01.2019, subjekti ka sqaruar se: *“Vlera e arredimit, e deklaruar në vitin 2002, është një lapsus në shkrim, të cilin do t’ju lutesha ta mirëkuptonit, sepse nuk ka asnjë arsye tjetër, të asnjë lloji, për të cilën viti 2002 (në vend të vitit 2003) mund të justifikonte diçka. Burim investimi për arredimin e apartamentit në vlerën prej rreth 1.500.000 lekësh, kanë qenë kursimet e deriatëhershme nga të ardhurat tona familjare. Po ashtu, subjekti sqaron se nuk ka ruajtur fatura të shpenzimeve të kryera 15 vjet më parë lidhur me blerjet për arredimin e apartamentit.”*

Komisioni kreu analizën financiare, e cila për vitin 2003 rezultoi me një bilanc negativ prej – 1.092.440 lekësh, për të parë nëse subjekti kishte burime të ligjshme për të kryer arredimin e apartamentit.

Pasi iu kalua barra e provës mbi këtë konstatim, subjekti, ndër të tjera, sqaroi se: “Në tabelën financiare të përpiluar nga ju, konstatoj se ka pasaktësi në disa zëra dhe në mospërfshirjen e të ardhurave reale për periudhën në shqyrtim, si më poshtë:

Analiza financiare në këtë tabelë është ndërtuar sikur familja ime, në fillim të vitit 2003, vinte me një gjendje “zero” likuiditetesh, edhe pse vetëm nga viti 2001–2002, të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortit ishin në masën prej 2.483.584 lekësh, si dhe të ardhurat nga karburanti në masën prej 800.000 lekësh. (Në fillim të vitit 2003, gjendja e trashëguar e kursimeve familjare ka qenë në masën prej 1.000.000 lekë.

Në tabelë nuk është përfshirë e ardhura nga karburanti në masën prej 1.000.000 lekësh.

Në tabelë, në zërin “Paga dhe shpërblime nga subjekti”, nuk është pasqyruar vlera prej 82.600 lekësh si e ardhur e ligjshme nga dietat e shërbimit.

Shpenzimet për punimet shtesë të apartamentit (1.400.000 lekë) janë kryer plotësisht në vitin 2004 dhe pasqyruar në tabelën e likuiditeteve për vitin 2004. Pra, ato nuk janë shpenzim për vitin 2003.

*Në tabelë, në zërin “Pasuri”, evidentohet si shpenzim (shlyerje e pjesës së mbetur për apartamentin e blerë) vlera prej 600.000 lekësh, që vjen nga shitja e apartamentit të vjetër. Sqaroj se kjo vlerë, që është realizuar si e ardhur në fund të nëntorit të këtij viti (kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 21.11.2003), nuk i është paguar firmës së ndërtimit këtë vit, por kjo vlerë ka qenë pjesë e këstit përfundimtar të pagesës së apartamentit që është realizuar në vitin 2004. Pra, për vitin 2003 nuk ekziston shpenzimi prej 600.000 lekë.*

Lidhur me shpenzimet e jetesës sipas ILDKPI-së, konstatoj se ato janë llogaritur të njëjta, si për vitin 2003 dhe 2004 ashtu edhe për vitin 2012, pavarësisht nga faktorët e ndryshuar ekonomikë e socialë, moshë e fëmijëve etj., megjithëse sipas ILDKPI-së shpenzimet për këtë periudhë kohore janë parashikuar në masën prej 438.228 lekësh për një familje me 4 anëtare siç jam edhe unë, duke i renduar shpenzimet e mia.

Në përfundim të sqarimit tim konfirmoj se unë dhe bashkëshorti im kemi pasur burime të mjaftueshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të këtij viti vetëm nga të ardhurat e këtij viti, pa llogaritur gjendjen e kursimeve familjare deri në vitin 2003”.

❖ Arsyetimi ligjor

Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, **Komisioni konstaton se:**

- Nga korrespondenca me zyrën e tatimeve, nuk ka informacion mbi xhiron dhe fitimin e kryer nga aktiviteti i pikës së karburantit. Gjithashtu, nga subjekti nuk u arrit të provohej në mënyrë bindëse burimi i krijimit dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat në lidhje me shumën prej 1.000.000 lekësh në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës, për rrjedhojë, nuk është

përshirë në analizën financiare e ardhura e deklaruar nga shitja e karburantit në shumën prej 1.000.000 lekësh;

- Në analizën financiare për vitin 2003 nuk është përfshirë edhe deklarimi i subjektit në shpjegimet e dërguara në lidhje me rezultatet e hetimit për kursime në shumën prej 1.000.000 lekësh në fillim të vitit 2003, sepse nga verifikimi i deklaratës së personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003, në formularin A-5 (likuiditete), faqja 8, nuk është pasqyruar në të asnjë gjendje në *cash* në llogari rrjedhëse, depozitë apo bono thesari.

- Në lidhje me mospërfshirjen e vlerës prej 82.600 lekësh të ardhura nga dietat e shërbimet, në zërin e të ardhurave sqarohet se kjo shumë është disbursuar për të përballuar shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe akomodimit në hotel, kështu që në vetvete kjo e ardhur është edhe shpenzim në vlerë totale.

- Në lidhje me shpenzimet për punime shtesë në apartamentin e banimit, të konsideruara nga ana e subjektit si të investuara në vitin 2002, në pyetësor nga ana e subjektit është deklaruar se këto shpenzime janë bërë në vitet 2003 dhe 2004. Ndërkohë që pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti e ka ndryshuar qëndrimin dhe ka deklaruar se punimet në shtëpi janë kryer në vitin 2004. Në analizën financiare është marrë në konsideratë qëndrimi i parë i subjektit që punimet në shtëpi i deklaroi të kryera për periudhën 2003-2004 dhe janë ndarë në mënyrë të barabartë për vitet 2003 dhe 2004.

- Shpenzimet jetike të familjes së subjektit janë llogaritur në vlerën minimum të tyre.

Në përfundim, subjekti nuk arriti të provojë bindshëm pretendimet e tij apo të vërtetojë me dokumentacion ligjor se shpenzimet për punime në shtëpi janë kryer në vitin 2004, sikurse pretendoi pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Analiza financiare për vitin 2003 rezulton si më poshtë:

Përshkrimi	2003
Të ardhurat	2,468,804
Nga pagat dhe shpërblimet - subjekti	968,804
Nga pagat - bashkëshorti ²⁰	900,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit ²¹	600,000
Shpenzime	3,561,244
Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së	775,857
Shpenzime mobilimi ²²	1,500,000

²⁰ Sipas shkresës nga SIGAL nr. *** prot., datë 17.04.2018, mbi të ardhurat e z. A. B, shtator 1999 – dhjetor 2016.

²¹ Të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me familjen Balli (P, I, A, A dhe Irma Balli), sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 21.11.2003.

²² Të deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard dhe të specifikuar në përgjigje të pyetësorit të ardhur pranë Komisionit në datën 11.01.2019.

Shpenzime për punime në shtëpi ²³	700,000
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	585,387
Pasuri	0
Shlyer pjesa e detyrimit të mbetur për apartamentin e banimit të blerë në Korçë ²⁴	0
Të ardhura - shpenzime – pasuri	1,092,440

Në bazë të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”.

Nga analiza financiare për vitin 2003 nuk rezultojnë burime të mjaftueshme e të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit dhe përballimin e shpenzimeve të tjera në shumën – 1.092.440 lekë.

2. Autoveturë tip “Toyota Rav4”, e përdorur, blerë vetë në Gjermani, me vlerë të përgjithshme 1.200.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes datë 22.05.2006, dhe deklaratës doganore datë 22.06.2006, me burim prej 500.000 lekësh nga shitja e një makine tip “Benz”, sipas kontratës së shitblerjes nr. *, datë 12.12.2007, dhe vlera prej 700.000 lekësh me burim: kursimet. Zotëron: 100 %.**

❖ Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugor²⁵ rezulton se sipas kontratës së shitblerjes të datës 22.05.2006, mjete tip “Toyota Rav4” është blerë në vlerën 4.000 euro. Sipas faturës bankare të datës 22.06.2006, në “Raiffeisen Bank”, z. A. B, ka paguar taksë zhdoganimi shumën prej 428.097 lekësh. Në total për blerjen e makinës janë shpenzuar 922.909 lekë, nga të cilat 4000 euro²⁶ (kontrata e shitblerjes) dhe shuma e zhdoganimit në vlerën prej 428.097 lekësh.

Në deklaratën e pasurisë - shtojca 2, personi i lidhur me subjektin, z. A. B, ka deklaruar për automjetin tip “Toyota Rav4”, shifrën 1.200.000 lekë dhe gjatë hetimit administrativ ka

²³ Subjekti deklaroi se po kryente punimet gjatë viteve 2003-2004 dhe që konsistonin në pajisjen e apartamentit me suva të brendshme, dyer të brendshme, pllaka dyshemeje, parket dhe hidrosanitare banjash në vlerën 1.400.000 lekë shumë e cila është ndarë në vitet 2003 dhe 2004 në mënyrë të barabartë.

²⁴ Pjesa e detyrimit për shtëpinë të e shlyer në vitin 2003 me burim të ardhurat e përfuara nga shitja e apartamentit të përfutur nga privatizimi është 600.000 lekë.

²⁵ Shihni në dosjen e Komisioni, shkresën nr. *** prot., datë 14.02.2018.

²⁶ Konvertuar në 494.812 lekë, bazuar te kursi mesatar i këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006.

shpjeguar se në këtë vlerë përfshihet edhe zhdoganimi sipas deklaratës doganore datë 22.06.2006 dhe shpenzime të tjera deri në pajisjen e automjetit me targa.

Në lidhje me burimin prej 500.000 lekësh, përfituar nga shitja e një makine tip “Benz”, sipas kontratës së shitblerjes nr. *, datë 12.01.2007, Komisioni konstaton se data e kontratës së shitblerjes është 12.01.2007 dhe, palët shprehen se e kanë likuiduar vlerën jashtë zyrës noteriale. Për rrjedhojë shuma prej 500.000 lekësh nuk mund të shërbejë si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit, tip “Toyota Rav4”.**

Gjithashtu, vetë automjeti tip “Benz 124” është deklaruar si i blerë në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003, në shumën prej 1.2 milionë lekësh, sipas kontratës së shitblerjes nr. *, datë 12.04.2000, me burim lekët e fituara nga z. A. B. si refugjat në Greqi në periudhën 1993-1994, burime financiare këto që nuk janë të mbështetura me dokumentacion justifikues ligjor.**

Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka shpjeguar: *“Është e vërtetë se shitja formale e mjetit “Benz” është bërë në datë 12.01.2007, bazuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, por shitja faktike dhe dorëzimi i mjetit te blerësi është bërë që në vitin 2016, menjëherë pas sjelljes në Shqipëri të mjetit “Toyota Rav4”. Ky fakt pasqyrohet edhe në këtë kontratë, kur thuhet se: “Vlera është bërë jashtë kësaj zyre dhe dorëzimi i mjetit është bërë fakt i kryer”. Makina i është dhënë blerësit në përdorim pa u formalizuar në momentin e dorëzimit, siç ndodhte rëndom në atë periudhë.*

Për këtë arsye, në deklarin vjetor të vitit 2007 nuk është deklaruar si e ardhur vlera e shitjes së mjetit “Benz” prej 500,000 lekësh, vlerë e cila është pasqyruar dhe konsumuar në vitin 2006 dhe në deklarin e mësipërm.

Lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj makine pothuajse e gjithë vlera vinte nga puna e bashkëshortit tim në Greqi, për të cilën, për kohën e gjatë që ka kaluar, 26 vjet, është e pamundur të paraqes dokumente justifikues në standardin që ju kërkoni...”.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2006, konstatohet se subjekti ka deklaruar pakësimin e pasurisë për blerjen e një makine “Toyota Rav4” në vlerën prej 1.200.000 lekësh, burimi: 700.000 lekë nga të ardhurat vjetore dhe 500.000 lekë nga shitja faktike e makinës tip “Benz”. Shitja formale është realizuar në janar 2007.

Analiza financiare për vitin 2006

Përshkrimi	2006
Të ardhurat	3,717,174
Nga pagat dhe shpërblimet – subjekti	1,493,170
Nga pagat – bashkëshorti	1,400,000

Të ardhura nga biznesi ²⁷	324,004
Të ardhura nga shitja e makinës	500,000
Shpenzime	1,881,579
Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së	775,857
Shpenzime udhëtimi ²⁸	711,821
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	393,901
Pasuri	1,422,064
Makinë Toyota	1,200,000
Kursime (Gjendje në fund – gjendje në fillim) ²⁹	222,064
Të ardhura – shpenzime – pasuri	413,531

Edhe në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në qershor të vitit 2016, ku subjekti është pyetur në lidhje me vlerën e këtij automjeti, ai ka deklaruar vlerën prej 1.200.000 lekësh dhe në analizën financiare të Komisionit është konsideruar kjo vlerë e blerjes së automjetit.

❖ Arsyetimi ligjor

Konkluzion

Për sa më sipër, duke marrë në analizë provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, Komisioni arrin në konkluzionin se ato janë bindëse në lidhje me faktin se çmimi prej 500.000 lekësh, i përfituar nga personi i lidhur me subjektin, z. A. B, nga shitja e automjetit tip “Benz”, me kontratën e shitblerjes të realizuar në datën 12.01.2007, çmim ky i paguar jashtë zyrës noteriale, pa u specifikuar se në cilën datë, është përdorur si burim për blerjen e automjetit tip “Toyota Rav4”, sipas kontratës së shitblerjes së datës 22.05.2006

Sipas analizës financiare për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë *automjet*, si dhe për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2006.

3. Garazh, ndodhur në katin përdhes të pallatit të banimit, ndodhur në adresën Lagja *, Rr. “***”, Korçë, me sipërfaqe 58 m², me vlerë prej 1.000.000 lekësh, blerë në vitin 2011, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 16.03.2011, me burim nga kursimet. Zotëron: 100 %.**

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

²⁷ Llogaritur në bazë të qarkullimit të vitit 2006, sipas një mesatareje të ponderuar, duke marrë në konsideratë fitimin e realizuar nga viti 2008 deri në vitin 2012, deklaruar xhiro sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nr. *** prot., me vlerë prej 8.000.100 lekësh dhe fitimi është llogaritur në bazë të qarkullimit të vitit 2006, sipas një mesatareje të ponderuar, duke marrë në konsideratë fitimin e realizuar nga viti 2008 deri në vitin 2012.

²⁸ Shpenzimet e udhëtimeve janë përllogaritur nga përgjigjet e pyetësorit, si dhe në bazë të procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja në qershor të vitit 2016, ku janë deklaruar shpenzimet e udhëtimeve.

²⁹ Në deklaratën e vitit 2006 deklarohet pakësim prej 1.200.000 lekësh për blerje makine dhe shtesë prej 1.000.000 lekësh, ndërsa në pyetësor ka pakësuar *cash* 1.200.000 lekë dhe ka shtuar bankën me 1.200.000 lekë; në fund të vitit 2005 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur likuiditete në shumën prej 2.888.361 lekësh (*cash* + bankë), kurse në fund të vitit 2006 kanë pasur likuiditete *cash* në shumën prej 1.718.000 lekësh dhe likuiditete në bankë në shumën prej 1.392.425 lekësh.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Korçë (me shkresën nr. *** prot., datë 13.02.2018), konfirmohet se z. A. B është pronar i pasurisë nr. ***, e llojit “njësi” me sipërfaqe 58 m². Kjo pasuri është fituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 16.03.2011 nga shoqëria “****”, për çmimin prej 1.000.000 lekësh, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Komisioni konstaton se ka mospërputhje në lidhje me llojin e pasurisë së konfirmuar nga ZVRPP-ja Korçë, që është “njësi”, dhe deklarin përkatës në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2011, si dhe në deklaratën “Vetting”, ku kjo pasuri deklarohet nga bashkëshorti juaj si e llojit “garazh”, duke u ngritur kështu dyshime në lidhje me masën e taksave të paguara nga subjekti në institucionet përkatëse, që për rastin konkret varen nga lloji i pasurisë dhe aktiviteti që ushtrohet në të.

Analiza financiare e vitit 2011 është pasqyruar në pikën 1.8, “Mbi të ardhurat dhe detyrimet tatimore nga dhënia me qira e karburantit”.

❖ Arsyetimi ligjor

Pas kalimit së barrës së provës subjekti sqaron se objektin e sipërcituar e kanë blerë si garazh dhe ka funksionuar gjatë gjithë kohës vetëm si garazh. Subjekti ka bashkëlidhur si provë edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.01.2019, të shtetasve M. Sh. K dhe B. P. Z, të cilët deklarojnë se në ambientin në katin përdhes të pallatit, z. A. B. ka një garazh, që e përdor si të tillë gjatë gjithë kohës.

Lidhur me analizën financiare të vitit 2011, pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaron si më poshtë:

“Në tabelën financiare të përpiluar nga ana juaj konstatoj se ka pasaktësi në disa zëra dhe mospërfshirje të të ardhurave reale për periudhën në shqyrtim, si më poshtë:

Analiza financiare në këtë tabelë është ndërtuar sikur familja ime, në fillim të vitit 2011 ka gjendje “zero” të likuiditeteve, ndërkohë që gjendja e kursimeve familjare në fillim të vitit 2011 ka qenë në masën prej 5.535.782.

Të ardhurat e mia të ligjshme janë në masën prej 2,009,141 lekësh (paga / shpërblime / bonus / dieta) dhe jo 1,401,141 lekë, siç paraqitet në tabelën tuaj.

Në tabelë nuk është përfshirë e ardhura nga qiraja e karburantit në masën 702,000 lekë, e vërtetuar plotësisht nga statementet bankare.

Lidhur me shpenzimet e fëmijëve, vlera në tabelë prej 842,350 lekësh është e pasaktë. Vlera e saktë është 695,000 lekë (4500 euro ose 625,000 lekë për shkollën e djalit + 70,000 lekë për shkollën e vajzës).

Në tabelë është i paqartë përcaktimi i gjendjes së kursimeve prej 947,444 lekësh.”

Në deklaratën periodike të vitit 2011 subjekti i rivlerësimit deklaroi shpenzime jetese etj., në shumën prej 1.350.000 lekësh, por pa specifikuar se çfarë përfshihen te këto shpenzime. Analiza financiare e vitit 2011 është bërë duke marrë si shpenzime jetese shumën që deklaroi subjekti si shpenzime jetese etj., në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2011.

Në analizën financiare të vitit 2011 janë marrë në konsideratë likuiditetet dhe për vitin 2011 shtesa në likuiditetet (*cash* dhe bankë) 947.444 lekë.

Të ardhurat nga qiraja e karburantit sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit nga “Raiffeisen Bank” e vëllait të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011 janë 630.000 lekë (pjesa takuese).

Në lidhje me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar shpenzime qiraje³⁰ gjatë periudhës nga 07.11.2010 deri më 30.12.2013, për kohën kur i biri ka qenë student në Tiranë, në shumën prej 12.500 lekësh në muaj.

Për sa i përket bonusit të karburantit, subjekti nuk ka arritur të shpjegojë në mënyrë bindëse dhe të provojë se cila është sasia e harxhuar dhe ajo e kursyer nga ky bonus.

Për sa më sipër, rezulton se ka mospërputhje në lidhje me llojin e pasurisë të konfirmuar nga ZVRPP-ja Korçë, që është “njësi” dhe deklarimin përkatës në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2011, si dhe në deklaratën “Vetting”, ku kjo pasuri deklarohet nga personi i lidhur me subjektin, z. A. B, bashkëshorti i subjektit, si e llojit “garazh”. Edhe në legjislacionin për pasuritë e paluajtshme, ato janë të përcaktuara si dy lloje të ndryshme pasurish, duke pasur edhe efekt të ndryshëm financiar në sistemin tatimor.

Nga analiza financiare për vitin 2011 nuk rezultojnë burime të mjaftueshme e të ligjshme financiare për blerjen e njësive dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera në shumën prej - 965,801 lekësh.

4. Depozitë bankare te “BKT”-ja, dega Korçë, viti 2014. Burimi: kursimet. Vlera: 3.000.000 lekë. Zotëron: 50%.

Komisioni është shprehur më lart për këtë depozitë.

5. Depozitë bankare në vlerën prej 1.500.000 lekësh te “NBG”-ja , dega Korçë. Burimi: kursimet. Zotëron: 100%.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

³⁰ Sipas deklaratës noteriale të datës 04.09.2018

“NBG”-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.01.2018, e konfirmon këtë depozitë. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka pasur të ardhurat për krijimin e saj.

➤ **Komisioni konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti është në përputhje me të dhënat e përcjella nga “NBG”-ja.**

6. Gjendje në llogarinë rrjedhëse e të ardhurave nga shoqëria “**”, te “Tirana Bank”, dega Korçë. Vlera: 1.553.538 lekë. Zotëron: 100 %.**

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

“Tirana Bank”, me shkresën me nr. *** prot., datë 08.02.2018, e konfirmon llogarinë rrjedhëse.

➤ **Komisioni konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti është në përputhje me të dhënat e përcjella nga “Tirana Bank”.**

7. Gjendje në llogarinë rrjedhëse të pagës nga “**”, te “Intesa Sanpaolo Bank”. Vlera: 287.831 lekë. Zotëron: 100 %.**

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

“Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *, datë 08.02.2018, e konfirmon këtë llogari. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka pasur të ardhurat për krijimin e saj.**

➤ **Komisioni konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti është në përputhje me të dhënat e përcjella nga “Intesa Sanpaolo Bank”.**

- **Interesa bankare te llogaria te “BKT”-ja, dega Korçë. Vlera: 354.371 lekë. Zotëron: 50%.**

Komisioni është shprehur më lart për këtë depozitë.

➤ **Mbi të ardhura nga shoqëria “****” sh.p.k.**

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaronte të ardhura nga biznesi me objekt “shitje me pakicë karburanti”, ku ai ka qenë ortak i shoqërisë “****” sh.p.k., me 25 %, i regjistruar me vendimin nr. ***, datë 09.10.1999, dhe me vendimin ***, datë 29.03.2001, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, NIPT ***E, biznes i mbyllur në vitin 2012. Vlera: **4.800.000 lekë.**

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2018, Komisioni i kërkoi të dhëna Bashkisë Korçë lidhur me të ardhurat e realizuara dhe fitimet e deklaruara nga subjekti tregtar “****” sh.p.k., përgjatë viteve 2003-2008.

Bashkia Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2018, kthen përgjigje se nuk disponon informacion të detajuar në lidhje me të ardhurat e realizuara dhe fitimin e deklaruar për vitet 2003 - 2008.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 13.04.2018, dërgon informacion mbi të ardhurat e realizuara dhe fitimet e deklaruara nga shoqëria “****” sh.p.k., si më poshtë:

Deklarimet ndër vite për shoqëritë “**” dhe “****”**

	Të ardhurat në lekë sipas deklaratave periodike vjetore	Të ardhura nga shoqëria “Ropi Co”, sipas shkresës nr. 6177/1 prot., datë 13.04.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë
Viti 2003 Ortak me 25 % të kapitalit të shoqërisë “Ropi Co”	1,000,000	
Viti 2004 Të ardhura nga shitja e karburantit nga shoqëria “Ropi Oil”, Korçë	1,200,000	
Viti 2005 Të ardhura nga biznesi i bashkëshortit deklaruar më parë	800,000	324,000 ³¹
Viti 2006 Të ardhura nga biznesi i bashkëshortit deklaruar më parë	200,000	324,004 ³²
Viti 2007 Të ardhura nga biznesi i bashkëshortit deklaruar më parë	200,000	-
Viti 2008 Të ardhura nga shitja e karburantit nga shoqëria “Ropi Oil”, Korçë	200,000	276,750
Viti 2009 Të ardhura nga shitja e karburantit nga shoqëria “Ropi Oil”, Korçë	200,000	276,975
Viti 2010	200,000	20,855

³¹ Deklaruar xhiro sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë nr.*** prot., me vlerë prej 8.000.000 lekësh dhe fitimi është llogaritur në bazë të qarkullimit të vitit 2005, sipas një mesatareje të ponderuar, duke marrë në konsideratë fitimin e realizuar nga viti 2008 deri në vitin 2012.

³² Deklaruar xhiro sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore, Korçë, nr.*** prot., me vlerë prej 8.000.100 lekësh dhe fitimi është llogaritur në bazë të qarkullimit të vitit 2005, sipas një mesatareje të ponderuar, duke marrë në konsideratë fitimin e realizuar nga viti 2008 deri në vitin 2012.

Të ardhura nga shitja e karburantit nga shoqëria “Ropi Oil”, Korçë		
Viti 2011 Të ardhura nga shoqëria “Ropi Co”, viti 2011, nga DRT, Korçë		24,055
Totali	4,000,000	1,246,639

Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se ka mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore në ILDKPKI për periudhën 2003–2010, në shumën prej 4.000.000 lekësh dhe deklarimeve në deklaratën “Vetting” që janë në shumën prej 4.800.000 lekësh. Ndërkohë që nga korrespondenca me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve konfirmohet si e ardhur nga biznesi për periudhën 2003–2011 shuma prej 1.246.639 lekësh.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti paraqiti shpjegimet e tij: *“Është e natyrshme mospërputhja e vlerave të deklaruara të të ardhurave nga biznesi, përderisa u referohem periudhave me gjatësi të ndryshme kohore. Në deklaratat periodike përfshihen të ardhurat për periudhën 2003 – 2010, pra, për një periudhë 8-vjeçare, në masën prej 4,000,000 lekësh. Në deklaratën “Vetting” jepen të ardhurat nga biznesi për periudhën 2001 – 2010 (pra, për një periudhë 10-vjeçare, në të cilën bashkëshorti ka qenë ortak në biznes) dhe vlera totale e këtyre të ardhurave është 4,800,000 lekë, sepse përfshin një periudhë më të gjatë deklarimi.*

Për më tepër sqaroj se, megjithëse DRT-ja Korçë, në vërtetimet e saj nuk jep të dhëna për vitin 2002, ne disponojmë të gjithë dokumentacionin financiar që vërteton aktivitetin e subjektit në këtë vit.”

Duke marrë në konsideratë pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”, në përfundim të hetimit administrativ Komisioni konsideroi si të ardhura të ligjshme ato që janë konfirmuar nga autoritetet përgjegjëse, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “*” sh.p.k.**

TË DHËNA TË TJERA TË DALA GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

➤ **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**³³, konfirmon ndër të tjera se bashkëshorti i subjektit, z. A. B, ka kryer transaksione si më poshtë:

1. “tërheqje cash” në datën 02.02.2009, në shumën 1.603.857 lekë, nga Banka Kombëtare e Greqisë;

³³ Për më tepër shihni në dosjen e Komisionit, shkresën nr. ***, datë 21.09.2018.

2. “shkëmbim valutor”, në shumën 26.000 euro³⁴, pranë Bankës Tregtare të Greqisë në datën 15.04.2009. “Shkëmbim valutor” nuk përmendet si transaksion në deklarinë periodik vjetor 2009, dorëzuar në ILDKPKI. Për këtë shumë nuk dihet as burimi i tyre as destinacioni.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Me pyetësorin e protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 29.10.2018, subjekti jep shpjegime mbi vlerën prej 1.603.837 lekësh tërhequr nga NBG-ja, në datën 02.02.2009, si vijon: “Në datën 28.02.2008, nga gjendja e kursimeve të mia, kam vendosur në NBG shumën prej 1.500.000 lekësh, si depozitë me afat 1-vjeçar. Në datën 02.02.2009, pas maturimit të depozitës 1-vjeçare, kam tërhequr nga banka vlerën prej 1.603.837 lekësh.

Kjo shumë e tërhequr i është shtuar kursimeve të mia në gjendje cash (jashtë sistemit bankar) dhe nuk ka pasur ndonjë qëllim investimi, në atë moment. Në lidhje me transaksionin e kryer nga bashkëshorti im, z. A. B, në datën 15.04.2009, në “NBG”, sqarohet se transaksioni i kryer konsiston në një veprim këmbimi të realizuar në bankë (NBG), ku sasia prej rreth 3.300.000 lekësh është këmbyer në 26.000 euro. Ky transaksion nuk shpreh dhe as përmban ndryshim të pasurisë, pra, të gjendjes cash të kursimeve të familjes sime...

Lidhur me burimin e vlerës prej rreth 3.300.000 lekësh, e cila është kthyer në euro, shpjegoj:

- Sipas edhe informacioneve që ju kam dërguar mbi likuiditetet progresive të familjes sime, rezulton se në fillim të vitit 2009 (31.12.2008), kursimet tona kanë qenë në vlerën e 2.390.674 lekëve në sistemin bankar dhe të 945,108 lekëve kursime cash jashtë sistemit bankar.
- Në datë 15.04.2009, pra, në datën kur është kryer këmbimi, gjendja e lekëve tona jashtë sistemit bankar ka qenë e mjaftueshme për të kryer transaksionin:
 - a. 945.108 lekë, gjendje e mbetur në cash që prej datës 31.12.2008;
 - b. 1.603.837 lekë të tërhequra nga NBG-ja, datë 02.02.2009, si maturim i depozitës 1-vjeçare;
 - c. 725.000 lekë, tërhequr nga llogaria ime bankare në Raiffeisen Bank, nga janari deri më 14.04.2009;
 - d. 420.000 lekë të tërhequra nga bashkëshorti im prej llogarisë së tij bankare te Tirana Bank nga janari deri më 14.04.2009.

Shuma prej 26.000 eurosh ka mbetur pjesë e gjendjes së kursimeve tona, në cash (jashtë sistemit bankar)....”.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegon se “Këmbimi i vlerës prej 3.380.000 lekësh në 26,000 euro, që konsiston në veprime transparente bankare, jashtë çdo dyshimi, nuk mund të konsiderohet “fshehje”, por mosdeklarim. Në formularin e DVP-së së vitit 2009, f. 3, citohet shprehimisht: “Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në:” Veprimi i këmbimit të mësipërm as pakëson dhe as shton vlerën totale të likuiditeteve të mia të asaj kohe.

³⁴ Konvertuar vlerën prej 26,000 eurosh në arkën e Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Korçë, në datën 15.04.2009 në vlerën 3.380.000 lekë me kursin 130.

Po kështu, në të njëjtin formular kërkohet të deklarohen “likuiditetet”, pa u shprehur kërkesa për paraqitjen e tyre të detajuara, sipas çdo monedhe të mundshme të poseduar nga subjekti.

Likuiditetet e mia janë shprehur gjatë gjithë kohës me korrektesë, sipas një vlerë totale vjetore në monedhën lekë, e cila, natyrshëm, përfshin edhe gjendjen e likuiditeteve në valutë, të konvertuara në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit për periudhën përkatëse.

Edhe në tabelat financiare të dërguara duket qartë se pakësimi i gjendjes bankare lidhur me këmbimin e sipërcituar përkon me rritjen në të njëjtën masë të gjendjes cash; pra, në total, gjendja e likuiditeteve të vitit 2009 është e njëjta, si në momentin para këmbimit ashtu edhe në atë pas këmbimit, me ndryshimin e raportit “lekë/euro” të likuiditeteve.

Pra, është e qartë se nuk ka as fshehje të shumës prej 26.000 eurosh, të këmbyer në bankë dhe as detyrim për t’u deklaruar kjo vlerë specifikisht në euro, ndërkohë që përfshihet në vlerën totale të likuiditeteve, në monedhën lekë”.

❖ **Arsyetimi ligjor**

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2009, në fushën që i korrespondon “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar:

- i pakësuar nga detyrimet për studimet e fëmijëve (shihni f. 5) – 700.000 lekë;
- ii mbyllur llogaria bankare te NBG Bank, nr. i kontratës ***, në datë 03.02.2009, principal + interes – 1.600.000 lekë;
- iii kursime *cash* – 2.000.000 lekë;
- iv shpenzime (jetese + pushime vjetore) – 1.144.000 lekë. 2.000.000 lekë si kursime *cash*.

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2009, në fushën që i korrespondon “të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar si të ardhura nga paga e vet dhe e bashkëshortit, si dhe nga aktiviteti i shoqërisë “****”, shumën totale prej 3.900.000 lekësh.

Të ardhurat e subjektit dhe të personit të lidhur me të për vitin 2009 në shumën prej 3.900.000 lekësh justifikojnë pothuajse në mënyrë të plotë shpenzimet e shkollimit të fëmijëve për këtë vit në shumën prej 700.000 lekësh + shpenzimet e jetesës dhe të pushimeve vjetore në shumën prej 1.144.000 lekë + kursimet në *cash* në shumën prej 2.000.000 lekësh, që shkojnë në total – 3.844.000 lekë.

Për sa më sipër duke marrë në konsideratë balancën thuajse të barabartë të ardhura – shpenzime për vitin 2009 dhe veprimet financiare të konkluduara me konvertimin në 26.000 euro, krijohet bindja se kemi të bëjmë me mosdeklarim të kësaj shume në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2009, as si gjendje *cash* dhe as si të investuar, nga ana e subjektit apo e personit të lidhur me të, bashkëshortit të saj, z. A. B.

➤ Në lidhje me mospërputhjen e konstatuar ndërmjet deklaramit nga ana e subjektit të kursimeve *cash* në deklaratat periodike vjetore për çdo vit deklarimi, shumës së shpenzimeve të mbuluara nga kursimet *cash* për çdo vit deklarimi, krahasuar me të dhënat për këto dy zëra të deklaruar nga ana e subjektit në përgjigje të pyetësorëve, edhe pas shpjegimeve përfundimtare të dërguara nga subjekti, referuar paraqitjes tabelare të të dhënave si më poshtë:

5. Vitet	Gjendja e kursimeve <i>cash</i> , sipas deklarimeve periodike	Shtesat në kursimet <i>cash</i> sipas deklaratave periodike	Pakësimet në kursimet <i>cash</i> , sipas deklarimeve periodike
2005	2,118,000	-	-
2006	918,000	-	1,200,000
2007	744,329	373,671	200,000
2008	-	-	744,329
2009	2,481,337	3,181,337	700,000
2010	4,202,363	2,491,026	770,000
2011	4,842,363	1,400,000	760,000
2012	6,642,363	1,800,000	-
2013	8,442,363	1,800,000	-
2014	6,227,459	1,500,000	3,714,904
2015	6,839,963	1,700,000	1,087,496
2016	2,459,490	-	4,380,473

Vitet	Gjendja e kursimeve <i>cash</i> , sipas deklarimeve pas rezultateve të hetimit	Shtesat në kursimet <i>cash</i> , sipas deklarimeve pas rezultateve të hetimit	Pakësimet në kursimet <i>cash</i> , sipas deklarimeve pas rezultateve të hetimit
2005	3,256,143	-	-
2006	2,043,867	-	1,212,276
2007	969,782	-	1,074,085
2008	945,108	-	24,674
2009	3,426,783	2,481,675	
2010	5,324,790	1,898,007	
2011	4,990,030		334,760
2012	6,423,118	1,433,088	-
2013	7,896,676	1,473,558	-
2014	5,024,852		2,871,824
2015	5,674,790	649,938	-
2016	1,500,000	-	4,174,790

Komisioni krijon bindjen se ka pasaktësi në lidhje për sa më sipër.

**VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Trupi gjykues, referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli:

a) ka pasaktësi në deklarin e burimeve financiare dhe pasurisë, deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë dhe të të ardhurave, si dhe ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse;

b) ka mospërputhje të dokumentacionit tekniko-ligjor të praktikës së lejes së ndërtimit të pasurisë “Karburant dhe ***,*** + ***”, të ndodhur në Drejtorinë Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan, me dokumentacionin e depozituar nga subjekti në ZVRPP-në Korçë për regjistrimin e kësaj pasurie, ndërkohë që ai duhet të ishte i njëjtë.

c) Nga analiza financiare rezulton se për vitet 2003, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për të justifikuar kryerjen e investimeve të deklaruara, si dhe shpenzimet e kryera.

Bazuar në sa më sipër, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

➤ **Nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sepse ka pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë dhe të të ardhurave, ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse, balancë financiare negative për vitet 2003, 2011 2012, 2013 dhe 2014, si dhe dyshime të arsyeshme për ndërhyrje të pajustificuar në dokumentacionin tekniko-ligjor të depozituar në ZVRPP-në Korçë për regjistrimin e pasurisë, duke bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë referuar nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016,**

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, me detyrë Prokurore/Drejtuese e Prokurorisë së Apelit Korçë.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.02.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim Hamitaj
Kryesues

Suela Zhegu
Anëtare

Olsi Komici
Relator

Etmonda Hoxha
Sekretare gjyqësore